



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 38

2001

Qershor

### P Ë R M B A J T J A

|                                       |  | Faqe |
|---------------------------------------|--|------|
| Vendim i KM<br>nr.440, datë 17.6.2001 | Për rregullat për formën dhe përmbajtjen e njoftimeve në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë .....  | 1195 |
| Vendim i KM<br>nr.441, datë 17.6.2001 | Për rregullat e drejtimit në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë .....  | 1199 |
| Vendim i KM<br>nr.442, datë 17.6.2001 | Për kërkesat financiare dhe ato kontabël të pjesëmarrësve në tregun e letrave me vlerë .....   | 1203 |
| Vendim i KM<br>nr.443, datë 17.6.2001 | Për rregullat për detyrimet e emetuesve për informim të vazhdueshëm .....  | 1209 |
| Vendim i GjK nr.49<br>datë 2.6.2001   | Me objekt shfuqizimin si antikushtetues i shkronjave “ç e d” të nenit 66 dhe pikës 3 të nenit 87 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” ..... | 1216 |

Vendim i GjK nr.53  
datë 27.6.2001

Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.76, datë  
2.3.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe të vendimit  
nr.361, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së  
Lartë..... 1223

*Vendim* (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sokol  
Nepi Bida ..... 1225

**V E N D I M**  
**Nr.440, datë 17.6.2001**

**PËR RREGULLAT PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E NJOFTIMEVE NË  
VEPRIMTARINË E INVESTIMIT NË LETRAT ME VLERË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 48 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjet nr.8168, datë 5.12.1996 dhe nr.8745, datë 22.2.2001, me propozimin e Minisrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. (1) Në këtë vendim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:  
- “Publikim” nënkupton çdo formë njoftimi, qoftë në formë deklarate, broshure, fletë palosje, reklame a lajmërimi, qarkoreje a dokumentesh të tjera ose nëpërmjet paraqitjes së fotografive, filmave, videove, transmetimeve radio-televizive nëpërmjet kompjuterëve a materialeve të shtypura ose nëpërmjet shpërndarjes së regjistrimeve a në ndonjë formë tjetër;  
- “Publikim për letrat me vlerë” nënkupton një publikim për a në lidhje me letrat me vlerë ose veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë.

(2) Në zbatim të këtij vendimi, një publikim i realizuar jashtë Shqipërisë do të trajtohet si i nxjerrë në Shqipëri, nëse:

u drejtohet personave në Shqipëri;

b) u vihet në dispozicion personave në Shqipëri, në mënyra të ndryshme nga publikimi i tij në një gazetë, të përditshme, revistë a botime të tjera të përditshme, të cilat publikohen dhe qarkullojnë kryesisht jashtë Shqipërisë ose nëpërmjet radios a televizionit, transmetimet e të cilëve drejtohen, kryesisht për jashtë Shqipërisë.

2. Kufizimet për publikimet

Me përjashtim të rasteve të përmendura në pikën 3, asnjë person tjetër përveç personave të licencuar nuk ka të drejtë të nxjerrë ose të përgatisë publikimin për letrat me vlerë në Shqipëri.

3. Përjashtimet nga kufizimet për publikimet

Pika 2 nuk zbatohet për:

(1) në publikim për letrat me vlerë, i nxjerrë ose që përgatitet të nxirret dhe që ka të bëjë vetëm letrat me vlerë të emetuara nga:

Qeveria e Shqipërisë ose qeveria e një shteti tjetër,

Banka Qendrore e Shqipërisë ose banka qendrore e një shteti tjetër.

(2) në publikim, i cili është një plan që duhet të regjistrohet nga Komisioni, sipas nenit 39 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”.

Përputhja e publikimeve me listën e kërkesave

Një person i licencuar nuk nxjerr apo përgatit nxjerrjen, qoftë në Shqipëri ose diku tjetër, të një publikimi për letrat me vlerë, nëse në këtë publikim nuk plotësohen kërkesat e mëposhtme:

I. Evidentimi i qartë i deklaratave

Në një publikim për letrat me vlerë nuk do të lejohet mosevidentimi, qartë e dukshëm, në raport me pjesën tjetër të publikimit ose përfshirja në të e materialeve të tjera, për të minimizuar rëndësinë e ndonjë deklarate a të materialeve të tjera, që kërkohen sipas dispozitave të këtij rregulli.

II. Publikimet duhet të jenë të qarta dhe orientuese.

(1) Përmbajtja e publikimit për letrat me vlerë dhe mënyra e paraqitjes së tij nuk duhet të lenë shteg për keqkuptime.

(2) Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë deklaram, premtim ose parashikim, nëse personi që e nxjerr atë nuk ndërmerr hapat e duhura për të siguruar shmangien e çdo keqkuptimi.

(3) Publikimi për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë deklaram, në të cilin personi që e ka nxjerrë atë, në bazë të të dhënave që ka, nuk beson në vërtetësinë e tij.

(4) Nëse objekti për të cilin bëhet publikimi për letrat me vlerë është i disponueshëm në një masë të kufizuar, për një kohë të kufizuar ose, në kushte të veçanta, për një kohë të kufizuar, atëhere publikimi e thekson me këtë fakt. Kur vlerësohet se një gjë e tillë nuk është e nevojshme, atëhere nuk përmban dyshime në lidhje me këtë.

### III. Publikimet duhet të veçohen nga çështjet e tjera

(1) Publikimi për letrat me vlerë dhe mënyra e paraqitjes së tij kanë të qartë karakteristikat e një publikimi që ka për qëllim promovimin e letrave me vlerë, promovimin e veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë ose të personave me të cilët lidhet ai.

(2) Nëse mjete të informacionit, përmes të cilit kryhet publikimi, përmban ose paraqet çështje ose informacione të tjera, është e detyrueshme që publikimi të dalë qartë dhe të veçohet nga çështjet e tjera.

### IV. Qëllimi real i publikimit

Publikimi i letrave me vlerë ka qëllim të krijojë bindje tek individët për objektin e publikimit. Nuk lejohet që publikimi të ketë qëllim krijimin e bindjeve tek individët për lidhjen e marrëveshjeve a për shërbime tregtare, që nuk përmenden në publikim.

V. Publikimet nuk duhet të lenë të nënkuptohet se gëzojnë miratimin e qeverisë ose të Komisionit.

Publikimet për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajnë ndonjë deklaratë nëpërmjet së cilës përcaktohet ose nënkuptohet se letrat me vlerë apo veprimtaria në letrat me vlerë janë miratuar nga qeveria apo Komisioni.

### VI. Kërkesat për të qenë i hapur dhe i drejtë

Një publikim për letrat me vlerë që përcakton vetëm disa nga të drejtat dhe detyrimet për një investim në letrat me vlerë ose vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet e një marrëveshjeje për veprimtaritë e investimit në letrat me vlerë, duhet:

(1) t'i përcaktojë ato në mënyrë të mjaftueshme, që t'i bëjë një paraqitje të qartë natyrës së investimeve në letrat me vlerë, të angazhimeve financiare, të ndërmarra nga investitori për përfshirje në investimin në letrat me vlerë, si dhe rreziqet që e shoqërojnë atë;

(2) të përcaktojë si sigurohet një deklaratë e tillë me shkrim.

### VII. Krahasimi me investimet apo shërbimet e tjera

Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të krahasojë ose të ballafaqojë një investim në letrat me vlerë me një investim alternativ ose një shërbim për letrat me vlerë me një tjetër alternativë për rastet kur krahasimi dhe ballafaqimi është i hapur dhe i drejtë, në lidhje me atë që promovohet dhe duke patur parasysh çfarë është thënë dhe çfarë nuk është thënë, por që nënkuptohet.

### VIII. Taksimi

(1) Një publikim për letrat me vlerë që i referohet taksimit duhet të përmbajë një paralajmërim se niveli dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë.

(2) Një publikim për letrat me vlerë, i cili përmban ndonjë çështje që bazohet mbi një normë të caktuar taksimi, duhet të përcaktojë kufijtë e normës.

(3) Një publikim për letrat me vlerë që u nënshtrohen lehtësirave nga taksimi:

a) duhet të përcaktojë se lehtësirat e përmendura janë ato që zbatohen sot për sot;

b) duhet të përmbajë një deklaratë që vlera e një lehtësie tatimore varet nga rrethanat e tatimpaguesit.

### IX. Mbarëvajtja në të kaluarën

Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë të dhëna për mbarëvajtjen në të kaluarën për investimin në letrat me vlerë, përveçse kur:

(1) ai është i nevojshëm për mbarëvajtjen e investimit në letrat me vlerë, subjekt i publikimit;

(2) përcaktohet qartë burimi i informacionit;

(3) në të gjithë informacionin përcaktohet se:

a) gjithçka që përfshihet është përfaqësuese, e ndershme a jomashtruese;

b) lënia jashtë e atyre fakteve që nuk janë përmendur nuk jep efektin e ekzagjerimit të suksesit ose mbarëvajtjes gjatë periudhës me të cilën lidhet ky informacion;

(4) informacioni i paraqitur në formën e grafikut ose të tabelës nuk lë pa përfshirë ndonjë

pjesë, në mënyrë që të japë një përshtypje mashtruese për ndryshimin e treguesve të ndryshëm;

(5) periudha që është zgjedhur për ilustrimin e mbarëvajtjes në të kaluarën të jetë të paktën trevjeçare dhe të mbarojë jo më shumë se tre muaj përpara datës së nxjerrjes së publikimit;

(6) publikimi përmban një paralajmërim se mbarëvajtja në të kaluarën nuk shërben si referencë për të ardhmen.

#### X. Paraqitja e shkallës së veprimtarive

(1) Një publikim për letrat me vlerë nuk duhet të përmbajë një deklaram, i cili paraqet shkallën e veprimtarive ose shtrirjen e burimeve të publikuesit ose të ndonjë grupi ku publikuesi është anëtar, për të krijuar përshtypjen se burimet e disponueshme, që shërbejnë për të mbështetur përmbushjen e detyrimeve të publikuesit, janë më të mëdha se në realitet.

(2) Deklaratat, që lidhen me burimet e anëtarëve të një grupi të ndryshëm nga publikuesi, duhet që ta paraqesin shprehimisht një fakt të tillë.

#### XI. Paralajmërimet për rrezikun

(1) Një publikim për letrat me vlerë sipas këtij paragrafi duhet të përmbajë një deklaratë ku nënvizohen rreziqet që shoqërojnë futjen në zotërim ose mbajtjen e letrave me vlerë, subjekt të këtij publikimi.

(2) Nëse publikimi ka të bëjë me një letër me vlerë, vlera në para e së cilës mund të ndryshojë, deklarata duhet të nënvizojë faktin se investitori mund të mos e rimarrë shumën e investuar.

(3) Nëse publikimi ofron një letër me vlerë që mund të sjellë të ardhura të larta ose që është e përshtatshme për një investitor, që kërkon fitime të larta nga investimi i tij, deklarata duhet të nënvizojë faktin se të ardhurat nga investimi mund ta ndryshojnë vlerën e tyre në para.

(4) Nëse publikimi lidhet me një letër me vlerë të emetuar në një monedhë të ndryshme nga ajo e vendit ku ka dalë publikimi, deklarata duhet të tërheqë vëmendjen për faktin se ndryshimet në kursin e këmbimit mund të shkaktojnë ulje ose ngritje të vlerës së letrës me vlerë.

(5) Kur publikimi për një letër me vlerë i jep të kuptojë investitorit, i cili hyn në një transaksion, se natyra e tij është e tillë që investitori mund të humbasë jo vetëm atë që paguan në fillim, por mund të jetë i detyruar të paguajë më vonë dhe shuma shtesë, të papërcaktuara, deklarata duhet ta nënvizojë këtë fakt.

(6) (a) Nëse letra me vlerë nuk tregtohet në një treg letrash me vlerë, të licencuara nga Komisioni, deklarata duhet të theksojë faktin se për këtë letër me vlerë nuk ka treg të licencuar dhe se investitori mund ta ketë të vështirë të shesë letrën me vlerë ose të sigurojë informacionin e duhur rreth vlerës së saj ose shkallës së rrezikut që ajo mbart.

(b) Nëse letra me vlerë tregohet në një treg të licencuar të letrave me vlerë, por tregtohet në mënyrë të parregullt dhe rrallë:

(I) që nuk mund të jetë i sigurt kuotimi i çmimit të saj gjatë gjithë kohës;

(II) që mund të jetë e vështirë të ekzekutohen transaksionet për ndonjë çmim që ajo mund të jetë kuotuar,

atëhere deklarata duhet të nënvizojë këtë fakt.

#### XII. Garantimi i të ardhurave

Në një publikim për letrat me vlerë nuk duhet që të ardhurat në vijim të investimit të paraqiten si të garantuara, të siguruara ose të premtuara, në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, me përjashtim të rasteve kur, para nxjerrjes së tij, është dhënë miratimi me shkrim, nga Komisioni.

#### XIII. Datimi

(1) Publikimi për letrat me vlerë në një gazetë duhet të ketë në cepin e poshtëm djathtas datën kur është nxjerrë për herë të parë.

(2) Publikimi për letrat me vlerë, nëpërmjet një plani, broshure, fletëpalosjeje ose literature të ngjashme marketingu, duhet të vendosë mbi kapakun e saj datën kur është nxjerrë për herë të parë.

(3) Publikimi për letrat me vlerë, i bërë nëpërmjet një filmi, videoje ose njoftimi televiziv duhet të paraqesë, në fillim ose në fund të materialit publikues, datën kur është nxjerrë për herë të parë.

#### XIV. Identifikimi i publikuesit

Një publikim për letrat me vlerë duhet të paraqesë personin e licencuar, i cili ka nxjerrë apo që bën të mundur nxjerrjen e publikimit, si dhe personin në emër të të cilit nxirret publikimi, kur ky i fundit është i ndryshëm nga personi i licencuar.

##### 5. Urdhrat për publikimet

(1) Nëse Komisioni gjykon se një publikim për letrat me vlerë, i nxjerrë ose që përgatitet apo propozohet të nxirret nga një person i licencuar, është i rremë, Komisioni nëpërmjet një njoftimi me shkrim, i jep personit të licencuar një urdhër ndalues ose detyrues.

(2) Ky urdhër mund të përmbajë një, disa ose të gjitha ndalimet ose detyrimet e mëposhtme:

(a) ndalimin e nxjerrjes së një lloji të veçantë publikimi;

(b) detyrimin, që publikimet, të cilat kanë një përshkrim të veçantë, të ndryshohen sipas një mënyre të caktuar;

(c) ndalimin e nxjerrjes së ndonjë publikimi i cili është tërësisht ose në pjesën më të madhe të tij, përsëritje e një publikimi të nxjerrë ose të propozuar për t'u nxjerrë një herë dhe që është përshkruar në urdhër;

(ç) detyrimin për të ndërmarrë në praktikë të gjithë hapat për tërheqjen nga qarkullimi apo paraqitja kudo të ndonjë publikimi apo të një prej publikimeve që kanë një përshkrim të veçantë, të specifikuar në urdhër;

d) detyrimin për një publikim të veçantë për publikimin e një korrigjimi të caktuar, në mënyrën dhe formën që përcaktohen nga Komisioni.

##### 6. Dërgimi Komisionit të kopjeve të publikimeve

Komisionit i dërgohet një kopje e çdo publikimi për letrat me vlerë, të nxjerrë ose që përgatitet të nxirret nga një person i licencuar.

##### 7. Kundërvajtjet në publikime

Një person i cili nxjerr ose përgatit nxjerrjen në Shqipëri të një publikimi për letrat me vlerë, nxjerrja e të cilit është ndaluar sipas pikës 2 ose që nuk përputhet me pikën 4, kryen shkelje dhe është i detyruar të paguajë një gjobë, në përputhje me dispozitat e nenit 63 të ligjit “Për letrat me vlerë”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

#### V E N D I M Nr.441, datë 17.6.2001

#### PËR RREGULLAT E DREJTIMIT NË VEPRIMTARINË E INVESTIMIT NË LETRAT ME VLERË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjet nr.8168, datë 5.12.1996 dhe nr.8745, datë 22.2.2001, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Në këtë vendim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

-”publikimi” nënkupton çdo formë njoftimi, qoftë kjo formë deklaratë, broshurë, fletë-palosjeje, reklame a lajmërimi, qarkoreje ose dokumentesh të tjera ose nëpërmjet paraqitjes së fotografive, filmave dhe videove, ose përmes transmetimeve në radio apo televizion, nëpërmjet kompjuterëve e materialeve të shtypura ose nëpërmjet shpërndarjes së regjistrimit ose në ndonjë formë tjetër;

-“klient” nënkupton personin për të cilin personi i licencuar vepron si agjent dhe për të cilin

ai është i detyruar të tregojë kujdes, si dhe personin klient të mundshëm;

-“llogari e fshehtë”, nënkupton një llogari mbi të cilën një bankë ose një tregtar i licencuar ka të drejtë të veprojë për llogari të klientit, brenda kufijve të vendosur me marrëveshje ndërmjet palëve;

- “mita” ka të njëjtin kuptim si në “Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”.

## 2. Zbatueshmëria

1. Këto rregulla zbatohen për personat e licencuar në veprimtarinë e investimit në letra me vlerë.

2. Këto rregulla zbatohen, përgjithësisht, për të gjitha veprimtaritë e investimit në letrat me vlerë, me kusht që, kur një rregull zbatohet vetëm në rrethana të veçanta, ky rregull do të zbatohet për personin e licencuar, vetëm nëse këto rrethana kanë lidhje të qartë dhe ndikojnë dukshëm në ecurinë e veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë, të ndërmarrë nga ky person i licencuar.

## 3. Deklarimi i pavarësisë dhe i paanësisë

Kur një person i licencuar këshillon një klient ose vepron për llogari të një klienti, ai:

1. nuk deklaron se është i pavarur ose i paaanshëm, nëse nuk është i tillë;

2. siguron se çdo deklaratë që bën për pavarësinë ose paanësinë e tij duhet të përfshijë ndonjë kufizim që mund të ekzistojë në secilën prej tyre.

## 4. Konflikti i interesave

Kur një person i licencuar ka interes material në një transaksion që ndërmerret për ose në lidhje me një klient ose ka hyrë në një marrëdhënie e cila shkakton konflikt interesash për këtë transaksion me vetëdije nuk duhet as të këshillojë dhe as të veprojë lidhur me këtë transaksion, përveç rasteve kur:

1. ia bën, ndershmërisht, të qartë klientit këtë interes material ose marrëdhënie;

2. ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar se as interesi material dhe as marrëdhënia nuk do të dëmtojnë interesat e klientit.

## 5. Mitat dhe stimujt

Një person i licencuar ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar se as ai dhe as ndonjë prej të punësuarëve ose agjentëve të tij nuk ofron, lejon, kërkon ose pranon mitë a ndonjë stimul, i cili mund të sjellë konflikt me ndonjë detyrim që ai ka ndaj klientëve.

## 6. Komunikimi i qartë, i drejtë dhe i ndershëm

1. Një person i licencuar pranon një komunikim nga një person tjetër, është caktuar të vërë në lëvizje ofrimin e shërbimeve në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë, vetëm nëse ai tregon arsye bindëse që të bëjnë të besosh se komunikimi është i saktë, i kuptueshëm dhe orientues.

2. Një person i licencuar ndërmerr hapat e nevojshme për të siguruar se çdo kontratë, komunikim, njoftim ose informacion, me shkrim që ai i jep apo i dërgon klientëve, të cilëve iu ofron shërbime në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë, është paraqitur drejt dhe qartë.

## 7. Sqarimi i klientit për rrezikun.

Një person i licencuar:

a) nuk i rekomandon klientit apo kryen një transaksion që ai e gjykon të arsyeshëm, me ose për të, nëse ai nuk ka marrë masat e duhura për t'i sqaruar klientit rreziqet që mbart transaksioni;

b) nuk udhëzon në mënyrë të gabuar një klient për avantazhet apo disavantazhet e një transaksioni;

c) nuk premtion të ardhura nëse të ardhura të tilla nuk janë garantuar me kontratë.

## 8. Informacioni për personin e licencuar

Një person i licencuar vë në dispozicion të klientit, të cilit i ofron shërbime në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë, të dhëna të mjaftueshme e informacion të saktë për identitetin dhe adresën e tij, si dhe të dhëna për identitetin dhe detyrën e përfaqësuesve të tij tregtarë, me qëllim mbajtjen e kontakteve me të.

## 9. Përfaqësuesit e personit të licencuar

1. Një person i licencuar duhet të jetë i sigurt, vazhdimisht, dhe mbi baza të arsyeshme, që çdo përfaqësues që ai cakton është i përshtatshëm të veprojë për të, në përputhje me detyrat e tij.

2. Personi i licencuar siguron, në mënyrë të arsyeshme dhe të vazhdueshme, se zotëron mjetet e nevojshme për të mbikëqyrur dhe detyruar zbatueshmërinë e standardeve të larta të etikës në veprimtarinë në letrat me vlerë, nga përfaqësuesit e tij.

#### 10. Rastet kur kërkohet lidhja e kontratës me klientin

1. Një person i licencuar nuk i ofron ndonjë klienti shërbime në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë që kanë të bëjnë me:

a) administrimin e fshehtë të një portofoli;

b) ndonjë lloj tjetër veprimtarie të përcaktuar nga Komisioni, me përjashtim të rastit kur ekziston një marrëveshje me shkrim, e firmosur nga klienti dhe që i është dorëzuar personit të licencuar.

2. Komisioni, herë pas here, mund të përcaktojë procedura të veçanta për funksionimin e llogarive të fshehta dhe çdo person i licencuar duhet t'i zbatojë këto procedura ose të sigurojë se ato janë zbatuar.

#### 11. Kontrata me Klientin

1. Kur një person i licencuar i ofron një klienti shërbime në investimin e letrave me vlerë, mbi baza të shkruara kontraktuale (qoftë sipas pikës 11 ose ndryshe), kontrata duhet të sqarojë me hollësi bazat mbi të cilat ofrohen këto shërbime.

2. Një gjykatë kompetente, nëse e gjykon të drejtë, vendos konstatimin ose shpalljen e pavlefshmërisë dhe korrigjimin e marrëveshjes së përmendur në pikën 1, por sidoqoftë, vendimi nuk mund të ketë efekte për transaksionet e filluara ose të zbatuara nga personi i licencuar për llogari të klientit.

#### 12. Të drejtat e klientëve

1. Një personi të licencuar nuk i lejohet që, nëpërmjet një njoftimi ose kontrate me shkrim, të kufizojë ose të përjashtojë:

a) një detyrë ose përgjegjësi ndaj një klienti, për sa kohë që kjo detyrë ose kjo përgjegjësi i takon me ligj apo përcaktohet nga rregullat e vendosura prej Komisionit;

b) çdo detyrë për të kryer ndaj një klienti, të cilit personi i licencuar i detyrohet, me aftësi, kujdes dhe saktësi, shërbimet që i ofron në investimin në letrat me vlerë;

c) çdo detyrim që i lind në rast mosrespektimi të shkronjës "b" të kësaj pike.

2. Çdo përjashtim ose kufizim i shprehur ose i nënkuptuar, i cili bie në kundërshtim me këtë dispozitë, është i pavlefshëm.

#### 13. Përshtatshmëria

Personi i licencuar duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar se nuk do të ofrojë këshillim në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë dhe nuk do të ndikojë në kryerjen e një transaksioni, me ose për një klient, për sa kohë që ky këshillim apo ky transaksion vlerësohet i papërshtatshëm, për aq sa rezulton nga faktet që i paraqet klientit apo nga fakte të tjera, të rëndësishme për klientin e për të cilat personi i licencuar është ose duhet të jetë në dijeni.

#### 14. Tarifat

1. Tarifat e vendosura nga personi i licencuar duhet të jenë të drejta në llojin e tyre ose të arsyeshme nga pikpamja e shumës së tyre, duke pasur parasysh gjithë rrethanat përkatëse.

2. Përpara se një person i licencuar t'i ofrojë një klienti shërbime në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë, duhet të njoftojë për tarifatat që kërkon për shërbimet që ofron, si dhe natyrën dhe shumën e çdo pagese tjetër që ai merr për këto shërbime.

#### 15. Konfirmimi dhe informimi periodik

1. Kur një person i licencuar kryen blerjen ose shitjen e letrave me vlerë për një klient, ai duhet të sigurojë se klientit do t'i dërgohet, brenda 24 orëve, një formular me shkrim, që përmban hollësitë kryesore të transaksionit.

2. Kur një person i licencuar vepron si një drejtues investimesh për një klient, siguron se klientit i dërgohet, në periudha të përshtatshme kohe, një raport, i cili paraqet vlerën e portofolit ose të llogarisë, në fillim dhe në fund të periudhës, përbërjen e tij në fund dhe, në rastin e një portofoli ose llogarie të fshehtë, ndryshimet në përbërjen e tij, ndërmjet këtyre datave.

#### 16. Përparësia e urdhrat të klientit



Një person i licencuar vepron për llogari të klientit dhe/ose për llogari të vet, me ndershmëri e në radhën e duhur.

#### 17. Zbatimi në kohën e duhur

Kur një person i licencuar bie dakord apo vendos me gjykimin e vet të zbatojë një urdhër të klientit, ai duhet të zbatojë ose të përfundojë zbatimin e këtij urdhri sa më shpejt që të jetë e mundur sipas rrethanave.

#### 18. Zbatimi më i favorshëm

Kur një person i licencuar kryen transaksione me ose për një klient duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të gjetur dhe për të vepruar në kushtet më të përshtatshme për klientin.

#### 19. Rregullimi dhe regjistrimi i shpejtë

Personi i licencuar duhet të sigurojë se transaksioni që ai zbaton rregullohet dhe regjistrohet menjëherë.

#### 20. Rregullimi dhe regjistrimi i drejtë

Kur personi i licencuar ka zbatuar bashkërisht një urdhër për llogari të klientit, me një urdhër për llogari të tij ose me një urdhër për llogari të një klienti tjetër, atëherë në rregullimet dhe regjistrimet në vijim:

a) ai nuk duhet t'i japë përparësi, në mënyrë të padrejtë, vetes apo ndonjë personi tjetër për të cilin tregtoi;

b) kur nuk mund të plotësohen të gjitha urdhrat, ai duhet t'u japë përparësi urdhrave në lidhje me transaksionet për klientët.

#### 21. Pritja e reagimit të klientit

Kur një person i licencuar ka si qëllim të publikojë për klientët një rakomandim, një studim ose analizë e cila ndikon në çmim nuk zbaton një transaksion për llogari të vet për investimin për të cilin bëhet fjalë apo investim tjetër që ka lidhje me të, derisa klientët, të cilëve u adresohet publikimi t'u jepet mundësia të reagojnë ndaj tij.

#### 22. Transaksionet e shpeshta

Një person i licencuar tregton ose organizon një tregtim kur vepron për një klient ose nuk i këshillon një klienti të tregtojë, kur ky tregtim, në përputhje me rrethanat, mund të gjykohet si shumë i shpeshtë ose shumë i madh.

#### 23. Mospërdorimi i të dhënave të brendshme

Një person i licencuar nuk duhet, që me vetëdije, të përfitojë ose të përpiqet të përfitojë, qoftë për veten e tij, ashtu edhe për llogari të një klienti apo pale të tretë, nëpërmjet të dhënave të brendshme që zotërohen prej çdo zyrtari, të punësuarit ose agjenti të tij apo të ndihmojë dikë tjetër me këto të dhëna, me qëllim nxitjeje fitimi.

#### 24. Ruajtja e investimeve të klientit

Një person i licencuar, i cili ka nën ruajtje letrat me vlerë të klientit, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë:

1. ruan ose organizon ruajtjen e çdo titulli ose dokumenti që evidenton titull për letrat me vlerë;

2. siguron se çdo letër me vlerë, që ai mban ose blen për një klient është regjistruar siç duhet në emër të tij ose me miratimin e klientit, në emër të një të autorizuarit të përshtatshëm.

#### 25. Ankesat

Një person i licencuar vendos procedura të brendshme për të siguruar trajtimin e duhur të ankesave të klientëve, ku duhet të përcaktohen mënyra dhe afatet për të korrigjuar situatën.

#### 26. Veprimi në përputhje me legjislacionin në fuqi

1. Personi i licencuar duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu vendosjen dhe zbatimin e procedurave, për të siguruar se:

a) zyrtarët, të punësuarit dhe përfaqësues të tjerë të tij janë në dijeni të detyrimeve që ata kanë ndaj dispozitave ligjore në fuqi dhe se ata veprojnë në mbështetje me këto dispozita;

b) regjistrohen dhe mbahen të dhëna të mjaftueshme për veprimtarinë e tij në letrat me vlerë dhe për zbatimin me përpikëri të dispozitave ligjore në fuqi.

2.Regjistrimet e mbajtura nga personi i licencuar, ashtu siç i kërkohen atij nga Komisioni, duhet të ruhen për një periudhë jo më pak se 6 vjet për t'u inspektuar nga persona të autorizuar nga Komisioni.

27. Mbikëqyrja

Personi i licencuar përcakton dhe zbaton procedura:

1.për mbikëqyrjen e secilit prej zyrtarëve, të punësuarëve të tij ose të përfaqësuesve të tjerë.

2.për të sigurur se asnjë prej këtyre këtyre personave nuk jep këshilla ose ofron shërbime të tilla, që janë jashtë përgjegjësisë të tij.

28.Ruajtja e sekretit të klientit

1.Të gjitha të dhënat që zotëron një person i licencuar për një klient janë konfidenciale dhe duhet të mbahen sekret prej tij.

2.Personi i licencuar mund të japë të dhëna për një klient, vetëm kur kjo i kërkohet nga Komisioni, nga një agjenci e pastrimit dhe e rregullimit të llogarive ose nga departamenti i mbikëqyrjes së tregut të licencuar të letrave me vlerë, anëtar i të cilit është ose kur urdhërohen nga një gjykatë e caktuar për të kryer një veprim të tillë.

29. Ndërprerja e veprimtarisë

Kur një person i licencuar vendos të tërhiqet nga veprimtaria e investimit në letrat me vlerë, ai

1. njofton menjëherë Komisionin dhe secilin prej klientëve të tij për këtë vendim;

2.e siguron Komisionin se çdo veprimtari e lënë pezull do të përfundojë ashtu siç duhet ose do t'i kalojë një personi tjetër, të licencuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Ilir Meta**

**V E N D I M**

**Nr.442, datë 17.6.2001**

**PËR KËRKESAT FINANCIARE DHE ATO KONTABËL TË PJESËMARRËSVE NË  
TREGUN E LETRAVE ME VLERË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 46 dhe 47 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", i ndryshuar me ligjet nr.8168, datë 5.12.1996 dhe nr.8745, datë 22.2.2001, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**I. TË PËRGJITHSHME**

1.Në këtë vendim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

- "bankë e aprovuar" nënkupton një bankë të licencuar, të miratuar nga Komisioni për efekt të këtij vendimi;

- "ekspert kontabël" për një person të licencuar nënkupton një kontabilist të pajisur me licencën për ekspert kontabël, i emëruar nga personi i licencuar si kontrollor i tij për qëllimet e këtij vendimi;

- "llogaria bankare klient" nënkupton një llogari bankare të hapur për qëllimet e përshkruara në këtë vendim;

- "para" përfshin çdo formë paraje, të përfaqësuar nga çeqe, forma të tjera urdhër-pagese apo në ndonjë formë tjetër.

2. Zbatueshmëria

Ky vendim zbatohet nga personat e licencuar nga Komisioni për të gjitha veprimtaritë e investimit në letrat me vlerë që ata drejtojnë.

## II.Regjistrimet kontabël dhe regjistrimet e tjera

### 3. Detyrimi për të mbajtur regjistrimet kontabël

(1) Një person i licencuar duhet të mbajë regjistrime kontabël për veprimtarinë e tij të investimit në letrat me vlerë, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të paraqitur dhe shpjeguar transaksionet e tij, (të kryera qoftë për llogari të tij, qoftë për të tjerët) dhe të tilla që:

a) të paraqesin sa më saktë dhe në çdo kohë, pozicionin financiar të personit të licencuar në atë çast;

b) t'i japë mundësi personit të licencuar për të përgatitur bilancin dhe llogarinë fitime-humbje, në çdo kohë dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

(2) Në veçanti, regjistrimet kontabël duhet të përmbajnë:

a) regjistrimet e përditshme të gjitha shumave të parave të arkëtuara dhe të shpenzuara nga personi i licencuar, si dhe përshkrimin e objektit të këtyre shpenzimeve apo arkëtimeve;

b) regjistrimin e të gjithave mjeteve dhe detyrimeve të personit të licencuar, duke përfshirë ndonjë premtim apo detyrim të tij të rastit;

c) regjistrimet e përditshme të të gjitha shitjeve dhe blerjeve të letrave me vlerë nga personi i licencuar, duke bërë dallimin ndërmjet atyre që janë bërë nga personi i licencuar për llogari të tij dhe atyre që janë bërë për llogari të të tjerëve;

ç) regjistrimet e përditshme të marrjes dhe të dërgimit të dokumentacionit të pronësisë ose të dokumenteve që evidencojnë pronësinë e letrave me vlerë, që janë në zotërim ose nën kontrollin e të licencuarit;

d) regjistrimet e përditshme:

(I) të të gjitha parave që janë derdhur në apo janë paguar nga një "llogari bankare klient", e mbajtur për qëllimet e këtyre rregullave;

(II) të arkëtimeve dhe të pagesave të parave të klientëve, të cilat nuk kanë kaluar përmes "llogarisë bankare klient", duke identifikuar personat me të cilët lidhet çdo arkëtim apo pagesë;

dh) regjistrime:

(I) të gjendjeve në "llogaritë bankare klient";

(II) të bilanceve me klientët individualë, duke treguar qartë emrin e secilit klient dhe shumën e mbajtur ose të marrë për atë klient;

e) hollësi për të gjitha letrat me vlerë:

(I) të cilat janë në pronësi të personit të licencuar, duke treguar se nga kush mbahen dhe, në rastet kur nuk mbahen nga vetë personi i licencuar, nëse mbahen si kolateral kundrejt huave apo paradhënieve;

(II) të cilat nuk janë në pronësi të personit të licencuar, por për të cilat ai është përgjegjës, duke treguar se për kë dhe kush i mban, duke bërë dallimin e atyre letrave me vlerë që janë depozituar pranë një pale të tretë, qoftë si garanci për huatë ose paradhëniet e dhëna personit të licencuar ose ndonjë personi tjetër të lidhur me të, qoftë për ndonjë qëllim tjetër.

### 4.Rinovimi i regjistrimeve kontabël

Detyrimet e përcaktuara në këtë vendim janë të vazhdueshme dhe kërkohet përmbushja e tyre, që të sigurohet rinovimi i përditshëm i regjistrimeve.

### 5.Sigurimi i lehtësive për ekspertin kontabël

(1) Informacioni që kërkohet të regjistrohet sipas kësaj rregulloreje duhet të regjistrohet në mënyrë të tillë që të mundësojë identifikimin e një transaksioni të veçantë në çdo kohë dhe ndjekjen e tij, që nga urdhri i fillimit e deri në rregullimin përfundimtar të transaksionit.

(2) Të gjitha regjistrimet duhet të sistemohen, skedohen, indeksohen dhe t'iu jepen referenca të sakta, në mënyrë që të mundësohet gjetja dhe kontrolli i shpejtë i ndonjë regjistrimi të veçantë.

### 6.Përputhje me standardet kontabël

Regjistrimet kontabël që kërkohen të mbahen nga një person i licencuar duhet të bëhen sipas praktikës së standardeve kontabël, të përcaktuara në dispozitat ligjore përkatëse.

### 7.Ruajtja e regjistrimeve

Një person i licencuar është i detyruar që regjistrimet që i kërkohen t'i mbajë sipas rregullit

4, t'i ruajë për një periudhë 6-vjeçare që nga çasti që ato janë regjistruar.

8. Inspektimi i regjistrimeve

Regjistrimet kontabël që kërkohen të mbahen sipas rregullit 4, në çdo kohë gjatë periudhës në të cilën kërkohen të ruhen, duhet që t'i paraqiten Komisionit ose ndonjë personi që ka autoritetin e Komisionit, sipas kërkesës që mund të specifikohet nga Komisioni ose nga personi, në kohën dhe vendin e përshtatshëm.

9. E drejta e tregut të letrave me vlerë për të vendosur kërkesa shtesë për anëtarët e vet

Asgjë në këtë kre (apo në kreun III) nuk e pengon një treg të licencuar të letrave me vlerë që të vendosë për personat e licencuar që janë anëtarë të tregut ndonjë detyrim ose kërkesë tjetër, të cilat mendohen si të nevojshme për:

a) mbajtjen e llogarive, librave dhe regjistrimeve;

b) paraqitjen e tregut, të raporteve financiare, periodike, në formën dhe mënyrën e kërkuar nga ai;

c) kontrollin e llogarive;

ç) informacionin që specialistët kontabël duhet të paraqesin;

d) kontrollet e befasishme të urdhrave të regjistruara.

III. Pasqyrat financiare dhe raportimet e tjera

10. Detyrimi për të përgatitur pasqyrat financiare

Një person i licencuar duhet të përgatisë, për çdo vit, pasqyrat vjetore financiare për veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë, të cilat duhet të konsistojnë në :

a) një bilanc në ditën e fundit të vitit financiar;

b) një llogari fitime-humbje për vitin financiar;

c) anekset.

11. Paraqitje e saktë dhe e vërtetë e të dhënave në bilanc

Bilanci duhet të japë një pamje të saktë dhe të vërtetë të situatës së veprimtarisë së personit të licencuar në fund të vitit financiar.

12. Paraqitja e saktë dhe e vërtetë e të dhënave në llogarinë fitime-humbje

Llogaria fitime-humbje duhet të japë një pamje të saktë dhe të vërtetë të fitimit apo të humbjeve të personit të licencuar për vitin financiar.

13. Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të personit të licencuar duhet të jenë në përputhje me planin e përgjithshëm kontabël, i cili zbatohet në vend, me dispozitat e tjera ligjore të lidhura me të, si dhe me standardet ndërkombëtare të kontabilitet.

14. E drejta e Komisionit për të kërkuar informacion

(1) Komisioni mund t'i kërkojë me shkrim personit të licencuar paraqitjen nga ana e tij të informacioneve periodike, siç mund t'i përcaktojë ai.

(2) Përveç informacionit të përditshëm të kërkuar sipas paragrafit 1, Komisioni mund t'i kërkojë personit të licencuar me shkrim, në përgjithësi apo për ndonjë rast apo grup rastesh të veçanta, t'i paraqesë Komisionit informacion shtesë, siç mund të përcaktohet.

15. Marrja e raportit të ekspertit kontabël nga personi i licencuar

(1) Personi i licencuar duhet t'i paraqesë pasqyrat e veta financiare vjetore ekspertit kontabël, për kontroll dhe duhet të marrë nga ai një raport që të jetë në përputhje me kërkesat e rregullit 18.

(2) Personi i licencuar i paraqet Komisionit raportin e ekspertit kontabël së bashku me: pasqyrën vjetore financiare, siç kërkohet në rregullin 17;

b) deklarin me shkrim se u është përmbajtur të gjitha rregullave që i janë kërkuar, si dhe informacion ose deklarin, të cilat Komisioni mund t'ia kërkojë sipas këtyre rregullave.

(3) Kur raporti i ekspertit kontabël vlerësohet i kufizuar ose i paqartë, nisur nga pikpamja e pasigurisë së ekspertit kontabël për saktësinë ose paraqitjen e plotë të regjistrimeve kontabël, personi i licencuar duhet që t'i paraqesë Komisionit, së bashku me raportin edhe një dokument me shkrim të nënshkruar nga drejtues.

Në raport të deklarohet:

a) nëse ekspertit kontabël i janë dhënë të gjitha regjistrimet kontabël të personit të licencuar për qëllimet e kontrollit të tij;

b) nëse të gjitha transaksionet e ndërrmarra nga personeli i licencuar janë pasqyruar dhe regjistruar me saktësi në regjistrimet kontabël të personit të licencuar;

c) nëse të gjitha regjistrimet e tjera të personit të licencuar dhe informacionet e tjera për to i janë dhënë ekspertit kontabël.

16. Paraqitja para Komisionit të pasqyrave vjetore financiare

Personi i licencuar t'i paraqesë Komisionit, brenda tre muajve pas përfundimit të vitit financiar, pasqyrat financiare vjetore, të kontrolluara nga eksperti kontabël.

17. Përmbajtja e raportit të ekspertit kontabël

(1) Raporti i ekspertit kontabël deklaron nëse pasqyrat financiare vjetore të personit të licencuar janë kontrolluar në përputhje me standardet e miratuara.

(2) Raporti i ekspertit kontabël gjithashtu saktëson nëse, sipas mendimit të tij:

a) pasqyrat financiare vjetore të personit të licencuar janë përgatitur saktë, në përputhje me këto rregulla;

b) bilanci jep një pamje të vërtetë, të saktë dhe të qartë të gjendjes financiare të veprimtarisë së personit të licencuar, në fund të vitit financiar;

c) llogaria fitime-humbje jep një pamje të vërtetë, të qartë dhe të saktë të fitimeve ose të humbjeve të personit të licencuar për vitin financiar.

ç) personi i licencuar, gjatë gjithë vitit financiar, ka mbajtur regjistrimet kontabël, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

d) personi i licencuar i ka mbajtur paratë e çdo klienti në rregull, të ndara nga ato të klientëve të tjerë, në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje;

dh) bilanci dhe llogaria fitime-humbje janë në përputhje me regjistrimet kontabël të personit të licencuar;

e) ai ka marrë të gjitha informacionet dhe shpjegimet të cilat, sipas dijenisë dhe gjykimit të tij, janë të nevojshme për kryerjen e kontrollit;

ë) personi i licencuar, gjatë gjithë vitit financiar, ka mbajtur sisteme të përshtatshme, të cilat i japin mundësi atij të identifikojë dokumentet e pronësisë apo dokumentet që evidentojnë pronësinë e letrave me vlerë, të cilat ai mban në ruajtje për llogari të klientëve të vet, në përputhje me rregullin 25 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për rregullat mbi etikën në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë".

f) personi i licencuar ka zbatuar kërkesat e rregullit 25 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për rregullat mbi etikën në veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë", në ditën në të cilën është përgatitur bilanci.

18. Raportet e kufizuara

(1) Nëse eksperti kontabël është i mendimit se një ose më shumë kërkesa të rregullit të mësipërm nuk janë përmbushur, e paraqet këtë fakt në raportin e vet, specifikon këto kërkesa dhe tregon aspektet ku kërkesat nuk janë përmbushur.

(2) Nëse eksperti kontabël nuk arrin të marrë të gjitha informacionet dhe shpjegimet të cilat, sipas dijenisë dhe gjykimit të tij, janë të nevojshme për qëllimet e kontrollit, ai duhet ta paraqesë këtë fakt në raportin që harton.

(3) Nëse eksperti kontabël nuk arrin të krijojë një mendim se një ose më shumë kërkesa të rregullit 18 janë plotësuar, ai e thekson këtë në raport duke i specifikuar këto kërkesa, si dhe jep shkaqet përse nuk ka qenë në gjendje të formojë një mendim për këtë problem.

IV. Paratë e klientit

19. Zbatueshmëria

Ky kre zbatohet në marrëdhëniet që lindin nga mbajtja ose marrja e parave të çdo klienti nga një person i licencuar, gjatë kryerjes së veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë.

20. Paratë e klientit

Për qëllimet e këtyre rregullave me "para të klientit" nënkuptohen paratë, në çfarëdo monedhe që, gjatë kryerjes së veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë, një person i licencuar mban ose merr për llogari të një klienti apo që ai i detyrohet klientit.

#### 21. "Llogaritë bankare klient"

(1) Një person i licencuar, që merr apo mban paratë e klientëve, duhet të hapë një a më shumë "llogari bankare klient" në një bankë të miratuar.

(2) "Llogaria bankare klient" mbahet e ndarë nga llogaritë ku ndodhen paratë e personit të licencuar.

(3) Personeli i licencuar, derdh menjëherë në "llogari bankare klient" të gjitha paratë e klientëve që i vijnë për a ose nga klientët.

#### 22. Mbajtja në mirëbesim e parave të klientëve

(1) Paratë e klientëve mbahen nga personeli i licencuar në mirëbesim dhe për llogari të klientëve përkatës, për të cilët janë marrë a mbahen këto para.

(2) Paratë e klientëve nuk janë pjesë e mjeteve të personit të licencuar, për çfarëdo qëllimi, dhe nuk janë subjekt i ndonjë detyrimi, që i licencuari i ka ndonjë kreditori.

#### 23. Njohja e saktë e gjendjes dhe përdorimi i parave të klientëve

Një person i licencuar duhet të jetë në gjendje të llogarisë, shpejt dhe saktë, paratë e çdo klienti dhe, në veçanti, duhet të sigurohet se:

a) paratë e klientëve nuk përzihen me paratë e tjera;

b) personi i licencuar, në çdo kohë, di me siguri se sa është teprica kreditore e çdo klienti;

c) paratë që i përkasin një klienti nuk përdoren për ndonjë klient tjetër.

#### 24. Pagesat nga "llogaria bankare klient"

(1) Duke përmbushur kërkesat e paragrafit 2 të këtij rregulli, paratë mund të tërhiqen nga "llogaria bankare klient" vetëm nëse:

a) ato nuk janë paratë e klientëve;

b) ato kërkohen qartë për kryerjen e pagesës ndaj ose për llogari të ndonjë klienti;

c) ato transferohen në një tjetër "llogari bankare klient" ose në një tjetër llogari bankare, që ekziston në emër të ndonjë klienti.

(2) Një person i licencuar mund të tërheqë paratë nga "llogaria bankare klient" për pagesën e kuotave ose të komisioneve të veta vetëm nëse kuotat ose komisionet përputhen me marrëveshjet e rënda dakord me klientët.

#### V. Emërimi i ekspertëve kontabël

#### 25. Detyrimi për të pasur ekspert kontabël

Një person i licencuar nuk mund të nisë veprimtarinë në letrat me vlerë pa emëruar një ekspert kontabël, në përputhje me këto rregulla.

#### 26. Kërkesat për emërimin e ekspertit kontabël

Asnjë person nuk mund të emërohet ekspert kontabël për një person të licencuar nëse nuk është kontabilist i pajisur me licensën përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### 27. Papërshtatshmëria për shkak të mungesës së pavarësisë

(1) Nuk vepron si ekspert kontabël për një person të licencuar asnjë personi që nuk plotëson kërkesat e paragrafit 2 të këtij rregulli.

(2) Një person është i papërshtatshëm për t'u emëruar si ekspert kontabël për një person të licencuar nëse ai është:

a) drejtues, zyrtar, i punësuar, aksioner, person i lidhur a partner i personit të licencuar;

b) partner ose i punësuar i ndonjërit prej personave të renditur në pikën a.

(3) Për qëllimet e këtij rregulli, eksperti kontabël i një personi të licencuar nuk vlerësohet si zyrtar apo i punësuar i personit të licencuar.

#### 28. Kontratat e angazhimit

Personi i licencuar duhet të sigurojë se eksperti kontabël, i emëruar sipas këtyre rregullave, ka autoritetet dhe detyrat e specifikuar në rregullin 30 dhe që:

a) këto autoritete dhe detyra janë përcaktuar në një kontratë angazhimi;

b) kontrata e angazhimit është nënshkruar nga personi i licencuar dhe nga vetë eksperti kontabël;

c) personi i licencuar mban një kopje të kontratës së angazhimit .

#### 29. Autoritetet dhe detyrat e ekspertit kontabël

(1) Një ekspert kontabël ka:  
a) të drejtën për të qenë i informuar gjatë tërë kohës dhe për të kontrolluar regjistrimet kontabël dhe të gjitha regjistrimet dhe dokumentet e tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e tij;  
b) të drejtën për të kërkuar nga personi i licencuar të gjitha informacionet dhe shpjegimet që ai i mendon të nevojshme për kryerjen e detyrave.

(2) Eksperti kontabël i paraqet Komisionit një raport për pasqyrat financiare vjetore, në përputhje me këto rregulla, i cili duhet të përmbajë çështjet e specifikuar në pikën 18.

(3) Gjatë përgatitjes së raportit, eksperti kontabël kryen hetime të tilla, që i japin mundësi të krijojë një mendim për çështjet të cilat, sipas pikës 18, duhet të përfshihen në raport.

30. Vënia në dijeni e Komisionit

Një person i licencuar, i dërgon brenda 7 ditëve njoftim me shkrim Komisionit për emërimin, shkarkimin ose dorëheqjen e një eksperti kontabël.

31. Dorëheqja apo shkarkimi i ekspertit kontabël

(1) Kur një ekspert kontabël jep dorëheqjen ose shkarkohet nga një person i licencuar, njoftimi që i dërgohet Komisionit, sipas pikës 30, duhet të përmbajë:

a) një deklaratë të nënshkruar nga eksperti kontabël, ku sqarohen rrethanat e dorëheqjes apo të shkarkimit të tij, të cilat eksperti kontabël mendon se duhet t'i bëhen të ditura Komisionit;

b) një deklaratë, të nënshkruar nga eksperti kontabël për rrethanat e dorëheqjes ose të shkarkimit.

(2) Mosemërimi i ekspertit kontabël në fund të afatit të emërimit të tij të mëparshëm quhet si shkarkim i tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI  
Ilir Meta

**V E N D I M**  
**Nr.443, datë 17.6.2001**

**PËR RREGULLAT PËR DETYRIMET E EMETUESVE PËR INFORMIM TË**  
**VAZHDUESHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.8080, datë 1.3.1996 "Për letrat me vlerë", ndryshuar me ligjet nr.8168, datë 5.12.1996 dhe nr.8745, datë 22.2.2001, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**KREU I**

1.(1) Në këtë vendim, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe:

"personi i lidhur" me drejtorin ose drejtorin ekzekutiv nënkupton:

a) bashkëshortin (bashkëshorten);

b) fëmijën, fëmijën e birësuar, nën moshën 18 vjeç ose fëmijën e bashkëshortit nën moshën 18 vjeç;

c) shoqërinë tregtare, ku ai është aksioner kryesor, dhe shoqërinë kontrolluese apo shoqërinë e kontrolluar prej saj, ku ai është aksioner/ortak kryesor;

- "drejtor ekzekutiv" nënkupton një person të punësuar nga një emetues, i cili, i vetëm ose

me persona të tjerë, është përgjegjës përpara autoritetit të këshilli mbikëqyrës për drejtimin e veprimtarisë së emetuesit;

-“drejtor” nënkupton çdo person, i cili zë pozicionin e drejtorit, pavarësisht nga emri me të cilin thirret;

-“veprimtari kryesor” për një emetues dhe për shoqëritë e kontrolluara prej tij nënkupton një veprimtari që në vitin financiar zë më shumë se 10 për qind:

a) të qarkullimit të përgjithshëm;

b) të rezultatit përfundimtar të veprimtarive (fitim ose humbje);

“aksioner kryesor” për një emetues nënkupton një person, i cili mban drejtpërdrejt ose tërthorazi 10 për qind a më shumë vota në çdo mbledhje të përgjithshme të asamblesë së emetuesit;

-“letra e shpërndarjes” në procesin e shpërndarjes së letrave me vlerë gjatë një emetimi të ri është dokumenti ku shënohen të gjitha detyrimet financiare të nënshkruesit të letrave me vlerë.

## 2.Zbatueshmëria

(1) Kjo rregullore zbatohet për marrëdhëniet që lindin kur letra me vlerë, si aksione, letra me vlerë të borxhit ose garanci (warrants) i ofrohen publikut ose zotërohen nga publiku.

(2) Për qëllim të interpretimit të këtyre rregullave:

a) letrat me vlerë quhen “të emetuara nëpërmjet ofertave publike”, nëse emetuesi ka publikuar një plan të regjistruar paraprakisht në Komisionin e Letrave me Vlerë, sipas nenit 39 të ligjit.

b) Letrat me vlerë quhen se “zotërohen nga publiku”, pavarësisht se kur janë emtuar nga emetuesi nëse:

(I) ato janë listuar në bursë ose janë lejuar për t’u tregtuar në të;

(II) janë më shumë se 50 zotërues të këtyre letrave me vlerë;

(III) komisioni, duke pasur parasysh fluksin apo vëllimin e tregtimit të letrave me vlerë, e pranon si të tillë dhe njofton me shkrim emetuesin për këtë, pavarësisht se kur dhe si është kryer ky tregtim.

## KREU II DETYRIMET PËR INFORMIM

### 3.Detyrime të përgjithshme

(1) Në përgjithësi dhe pavarësisht nëse pajtohet apo jo me kërkesat specifike të kësaj rregulloreje, një emetues duhet të njoftojë menjëherë Komisionin dhe bursën, nëse letrat me vlerë të tij janë listuar në bursë ose janë lejuar për t’u tregtuar në të, si dhe anëtarët e tij dhe zotëruesit e tjerë të letrave me vlerë të tij për çdo zhvillim të ri të rëndësishëm në sferën e veprimtarisë të vet që nuk është bërë i njohur publikisht dhe kur një informacion i tillë:

a) është i domosdoshëm që t’u mundësojë atyre dhe publikut vlerësimin e pozitës financiare të emetuesit dhe të të kontrolluarëve prej tij;

b) është i domosdoshëm të shmangë krijimin e një tregu të rremë për letrat me vlerë të tij;

c) përpiqet të sjellë një ndryshim të dukshëm në çmimin e tyre.

Në kuptim të paragrafit (1), të nenit 42 të ligjit nuk janë të detyrueshme për informim:

a) informacionet a për zhvillimet e afërta ose për çështjet në diskutim, nxjerrja e të cilave, sipas emetuesit, do të çonte në një ndryshim konkret në çmimin e letrave me vlerë dhe për të cilat emetuesi duhet të njoftojë pa vonesë bursën ose të paktën ta paralajmërojë atë për efekt që do të kishte kjo;

b) informacionet që i janë paraqitur publikut sipas paragrafit (1) në ato raste kur, sipas bursës, ky informacion bie ndesh me interesat e ligjshme të emetuesit.

### 4.Dërgimi i pasqyrave financiare

Emetuesi do t’i dërgojë Komisionit, bursës, çdo anëtar të tij dhe zotëruesve të letrave me vlerë të tij (jo të atyre letrave me vlerë që i paguhen prurësit në të parë), një kopje të pasqyrave financiare, vjetore, raportin e ekspertëve kontabël dhe raportin e drejtorëve të tij për vitin financiar të mbyllur, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së mbledhjes së përgjithshme vjetore të asamblesë së emetuesit dhe jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të këtij viti financiar.



## 5. Informacioni që shoqëron raportin e drejtorëve

Emetuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë raportin vjetor të drejtorëve edhe:

a) një përshkrim të veprimtarive kryesore të tij dhe të shoqërive të kontrolluara prej tij dhe, në rastin kur përshkruhen dy ose më shumë veprimtari, një deklaratë ku pasqyrohet kontributi që zë, përkatësisht, çdo veprimtari në qarkullimin e përgjithshëm dhe në fitimin e tij;

b) një analizë gjeografike të qarkullimit të përgjithshëm dhe të kontributit që zënë në rezultatin tregtar veprimet tregtare, të ndërmarra jashtë Shqipërisë nga emetuesi dhe shoqëritë e kontrolluara prej tij;

një deklaratë ku të tregohen:

(I) emri i çdo shoqërie të kontrolluar, vendi kryesor i zhvillimit të veprimtarisë, vendi i krijimit të tyre dhe veprimtaria kryesore;

(II) hollësi për kapitalin aksioner dhe letrat me vlerë të borxhit, të emetuara prej çdo shoqërie të kontrolluar prej tij.

Nëse numri i shoqërive të kontrolluara është i tillë sa që informacioni për to do të rezultonte i vëllimshëm, ky informacion nuk paraqitet, me përjashtim të rastit kur këto shoqëri kryejnë një veprimtari, rezultatet e së cilës ndikojnë dukshëm në sasinë e fitimit apo në humbjet e emetuesit ose në vlerën e mjeteve të tij;

(ç) një deklaratë, në fund të vitit financiar, ku të tregohen:

(I) interesat e çdo drejtori, drejtori ekzekutiv të emetuesit dhe të personave të lidhur me ta për aq sa mund të njihen apo mund të sigurohen të dhëna, në aksionet apo në letrat me vlerë të borxhit të emetuesit ose të ndonjë shoqërie të kontrolluar prej tij;

(II) hollësitë për çdo të drejtë që i jepet çdo drejtori apo drejtori ekzekutiv të emetuesit dhe personave të lidhur me ta, për aq sa mund të njihen apo mund të sigurohen të dhëna për të nënshkruar kapitalin e vet dhe letrat me vlerë të borxhit, si dhe hollësitë për ushtrimin e këtyre të drejtave;

deklarata e kërkuar sipas shkronjës “ç” duhet:

(I) të bëjë dallimin ndërmjet interesave, përfituese dhe jopërfituese;

(II) të specifikojë shoqërinë tregtare, letrat me vlerë të së cilës ai zotëron, klasën (kategorinë) së cilës ato i përkasin dhe numrin e këtyre letrave me vlerë;

(dh) në rast se rezultatet e paraqitura në pasqyrat në pasqyrat financiare ndryshojnë dukshëm nga çdo parashikim i bërë dhe i publikuar nga emetuesi, të jepet një shpjegim për këtë ndryshim.

e) një deklaratë nga drejtorët ku të paraqiten arsyet e çdo shmangieje të dukshme nga kërkesat e planit të përgjithshëm kontabël, të zbatuar në Shqipëri;

ë) një deklaratë për:

- huatë bankare dhe gjendjet pasive të llogarive të tij;

- të gjitha huatë e tjera të emetuesit dhe të shoqërive të kontrolluara të tij, si dhe shumën kumulative të pagueshme:

I. në çastin e kërkuar prej huadhënësit ose brenda një viti;

(II) brenda një periudhe jo më pak se 1 vit, por jo më shumë se 2 vjet;

(III) brenda një periudhe jo më pak se 2 vjet, por jo më shumë se 3 vjet;

(IV) brenda një periudhe më shumë se 3 vjet;

f) një pasqyrë, për vitin financiar të shumës së interesit të kapitalizuar gjatë vitit nga emetuesi dhe shoqëritë e kontrolluara prej tij;

g) një deklaratë për periudhën ende në fuqi të ndonjë kontrate pune, e cila nuk mund të ndryshohet nga punëdhënësi brenda një periudhe njëvjeçare, pa pagesë kompensuese (përveç ndonjë kompensimi ligjor) të ndonjë drejtori të propozuar për t'u zgjedhur në mbledhjen vjetore të ardhshme të asamblesë së përgjithshme. Nëse nuk ka kontrata të tilla, lëshohet deklaratë e cila vërteton këtë fakt;

gj) përmbledhje e hollësive të ndonjë kontrate të rëndësishme, që ka qenë gjatë vitit financiar apo që është ende në fuqi, ku një drejtor i emetuesit ishte ose është, materialisht, i interesuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi. Nëse nuk ka kontrata të tilla, lëshohet një deklaratë, e cila e vërteton këtë fakt.

h) përmbledhje të hollësive të ndonjë kontrate të rëndësishme, të lidhur ndërmjet emetuesit

apo ndonjerës prej shoqërive të kontrolluara prej tij dhe një aksioneri kontrollues apo shoqërive të kontrolluara prej tij;

i) përmbledhje të hollësive të ndonjë kontrate të rëndësishme, përsa u përket kushteve të shërbimeve që u bëhen emetuesit dhe shoqërive të kontrolluara prej tij nga një aksioner kontrollues dhe shoqëritë e kontrolluara të këtij të fundit;

j) një përmbledhje, në formën e një table krahasese, ku të paraqiten rezultatet financiare, mjete dhe detyrimet e emetuesit dhe të shoqërive të kontrolluara prej tij, për 5 vitet e fundit financiarë, të shoqëruara me shpjegime ose sugjerime të nevojshme për ndryshimet në kapital, duke e bërë më të dukshëm krahasimin e një viti me tjetrin.

#### 6. Raportet financiare

(1) Emetuesi është i detyruar të përgatisë për 6-mujorin e parë të çdo viti financiar një raport të përkohshëm, ku jepen të dhënat e kërkuara sipas paragrafit (2) dhe, jo më vonë se 4 muaj pas mbarimit të kësaj periudhe 6-mujore, emetuesi duhet që:

(I) një ditë pas miratimit të informacionit nga bordi, të publikojë, të paktën në 2 gazeta me qarkullim kombëtar, një lajmërim me informacionin e kërkuar sipas paragrafit (2), i cili përfshihet edhe në raportin e përkohshëm;

II. për këtë lajmërim, vë menjëherë në dijeni Komisionin e Letrave me Vlerë për emrat e gazetave përkatëse dhe datën e publikimit. Brenda një periudhe të arsyeshme kohe u dërgon një kopje të raportit të përkohshëm bursës dhe çdo anëtar i zotëruar të letrave me vlerë të tij.

(2) Çdo raport i përkohshëm, sipas paragrafit 1, do të përmbajë, për emetuesin dhe shoqëritë e kontrolluara prej tij, të paktën këto të dhëna:

(I) vëllimin e përgjithshëm të qarkullimit;

(II) rezultatit financiar përpara tatimit dhe të të ardhurave apo shpenzimeve të jashtëzakonshme, të shoqëruara me specifikat përkatëse, duke treguar nëse janë të jashtëzakonshme për shkak të madhësisë apo për ndonjë arsye tjetër;

(III) tatimin mbi fitimin (në Shqipëri dhe jashtë), duke treguar për secilin rast bazën e përlllogaritjeve;

(IV) fitimin që u përket aksionerëve, që përbëjnë pakicën;

(V) fitimin që u përket aksionerëve, para të ardhurave apo shpenzimeve të jashtëzakonshëm

(VI) të ardhurat apo shpenzimet e jashtëzakonshme (pa tatimet);

(VII) fitimin që u përket aksionerëve;

(VIII) shumën e dividendit, të paguar ose të propozuar për t'u paguar, për çdo aksion, të shoqëruar me hollësitë përkatëse, si dhe një pasqyrë shoqëruese të shumës së dividendit të papaguar ose një deklaratë negative, përkatëse;

(IX) transfertat për dhe nga rezervat;

(X) të ardhurat për aksion, të llogaritura mbi bazën e fitimeve përpara llogaritjes së të ardhurave apo shpenzimeve të jashtëzakonshme;

(XI) shifrat krahasuese, të specifikuara nga 1 te (X) edhe për të njëjtën periudhë paraardhëse;

(XII) një deklaratë për interesat e çdo drejtori, drejtori ekzekutiv të emetuesit dhe të personave të lidhur me ta, për aq sa mund të njihen apo mund të sigurohen informata, në aksionet apo letrat me vlerë të borxhit të emetuesit ose të ndonjë shoqërie të kontrolluar prej tij. Kjo deklaratë duhet të bëjë dallimin ndërmjet interesave, ekonomike dhe joekonomike, duke specifikuar shoqërinë aksionere dhe numrin e aksioneve që zotërojnë.

(3) Në informacionin kontabël, të përfshirë në raportin e përkohshëm duhet theksuar nëse ai është kontrolluar ose jo nga ekspertët kontabël. Kur informacioni kontabël është kontrolluar nga ekspertët kontabël të emetuesit, konkluzionet e nxjerra nga ky kontroll të përfshihen në raport.

(4) Çdo njoftim paraprak për rezultatet për vitin e plotë të përmbajë edhe informacionin e kërkuar sipas paragrafit (2).

#### 7. Blerja dhe transferimi i mjeteve (aseteve)

(1). Emetuesi vepron në përputhje me kërkesat e paraqitura në paragrafin (2), kur:

a) kryhet ndonjë blerje apo transferim i mjeteve nga emetuesi ose nga shoqëritë e kontrolluara prej tij, ku:

(I) mjetet e blera apo të transferuara përfaqësojnë një shumë më të madhe se 15 për qind e vlerës së mjeteve të emetuesit ose të mjeteve të konsoliduara, sipas rastit siç mund të paraqiten në pasqyrat e fundit financiare të kontrolluara nga eksperti kontabël;

(II) mjetet janë transferuar apo blerë nga ndonjë drejtor, drejtor ekzekutiv i emetuesit a i shoqërive të kontrolluara prej tij, apo nga ndonjë person i lidhur me ta;

(III) mjetet janë transferuar apo blerë nga ndonjë shoqëri tregtare, ku aksioneri kryesor është drejtor, drejtor ekzekutiv i emetuesit a i shoqërive të kontrolluara prej tij, apo person i lidhur me ta;

b) mjetet e transferuara nga emetuesi a nga shoqëritë e kontrolluara prej tij, realizojnë një fitim neto para tatimit në një masë më të madhe se 15 për qind e fitimit para tatimit të realizuar nga mjetet e konsoliduara, të paraqitura në pasqyrat e fundit financiare, të kontrolluara nga ekspertët kontabël.

(2) Në rastet kur zbatohet paragrafi (1), emetuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe pa vonesë Komisionin, bursën, çdo anëtar dhe zotërues të letrave të tij me vlerë për transaksionet e kryera, duke përfshirë hollësitë e mëposhtme:

datën dhe palët pjesëmarrëse në transaksion;

b) një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së mjeteve, nëse këto mjete janë tërësisht ose pjesërisht, aksione, emrat dhe një përshkrim të përgjithshëm të veprimtarive të shoqërive që i kanë emetuar këto aksione;

c) vëllimin e përgjithshëm, të paguar dhe afatin e pagesës;

ç) në rastin e një transaksioni, që i referohet paragrafit (1), (a/1) ose (1/b), bazën e vlerësimit të mjeteve në çastin e blerjes a të transferimit dhe, në rastin e një transferimi mjetesh, tepicën ose deficitin e të ardhurave, të realizuara nga ky transaksion, në krahasim me vlerën kontabël;

d) në rastin e një transaksioni të përcaktuar në paragrafin (I) (a) (II), (III), emrin e drejtorit ose të drejtorit ekzekutiv a të personave të lidhur me ta;

(I) në rastin e drejtorit ose të drejtorit ekzekutiv, postin që mban;

(II) në rastin e personave të lidhur me ta, natyrën e marrëdhënieve, emrin e drejtorit ose të drejtorit ekzekutiv dhe postin që mban.

8. Transaksionet ndërmjet shoqërive të lidhura, në rastet kur emetuesi është një shoqëri e kontrolluar

(I) Për qëllime të këtij rregulli “transaksion” nënkupton:

a) një rregullim ose një marrëveshje, nëpërmjet së cilës emetuesi drejtpërdrejt apo tërthorazi jep një hua ose asistencë tjetër financiare;

b) një rregullim ose një marrëveshje nëpërmjet së cilës emetuesi jep një siguri, qoftë nëpërmjet një garancie a në ndonjë formë tjetër, për shlyerjen e çdo detyrimi;

c) çdo lloj transaksioni tjetër, përveç atyre që zhvillohen gjatë një veprimtarie të zakonshme biznesi.

(2) Emetuesi do të veprojë në përputhje me kërkesat e paraqitura në paragrafin (3), kur një transaksion i specifikuar në paragrafin e mësipërm kryhet ndërmjet:

a) emetuesit dhe shoqërisë së tij kontrolluese;

b) emetuesit dhe çdo shoqërie të kontrolluar të shoqërisë së tij kontrolluese, e ndryshme nga shoqëritë e kontrolluara nga emetuesi;

c) një shoqërie të kontrolluar të emetuesit dhe shoqërisë kontrolluese të emetuesit;

ç) një shoqërie të kontrolluar të emetuesit dhe çdo shoqërie të kontrolluar nga shoqëria kontrolluese e tij, të ndryshme, këto të fundit, nga emetuesi ose nga çdo shoqëri e kontrolluar e tij.

(3) Në rastet kur zbatohet paragrafi (2) emetuesi duhet të njoftojë menjëherë Komisionin, bursën dhe çdo anëtar e zotërues të letrave të tij me vlerë, duke dhënë edhe hollësitë e mëposhtme:

a) datën e transaksionit dhe palët pjesëmarrëse në të;

b) natyrën e përgjithshme të transaksionit;

c) shumën ose vlerën e transaksionit kur transaksioni ka të bëjë me dhënien e ndonjë huaje, asistencë financiare, apo dhënien e ndonjë garancie;

9. Njoftimi për mbledhjen e përgjithshme të asamblesë

Emetuesi duhet të publikojë njoftimin për çdo mbledhje të përgjithshme të asamblesë, të

paktën, në 2 gazeta me qarkullim kombëtar.

#### 10. Vendimet pas mbledhjes së bordit

Emetuesi duhet të informojë Komisionin e Letrave me Vlerë dhe bursën menjëherë pas miratimit, nga ose në emër të bordit, për:

a) ndonjë vendim ku deklarohet, rekomandohet ose paguhet dividend ose bëhet ndonjë shpërndarje tjetër në letrat me vlerë të tij, si dhe përqindja dhe shuma e sa më sipër;

b) ndonjë vendim për mosdeklarim, rekomandim ose pagesë dividenti, i cili, në kushte të tjera, pritej të deklarohet, rekomandohej apo paguhej gjatë kësaj kohe;

c) ndonjë njoftim paraprak të fitimeve ose të humbjeve për vitin, për gjysmën e vitit ose për ndonjë periudhë tjetër kohore.

ç) ndonjë ndryshim të propozuar në strukturën e kapitalit, duke përfshirë ndonjë rimbursim të letrave me vlerë të konvertueshme;

d) ndonjë vendim që ndryshon karakterin e përgjithshëm ose natyrën e biznesit të emetuesit ose të shoqërive të kontrolluara prej tij.

#### 11. Komisioni njoftohet për një kategori të caktuar vendimesh

Emetuesi informon menjëherë Komisionin dhe bursën për çdo vendim të marrë, për:

a) ndonjë ndryshim në statutin e emetuesit;

b) ndonjë ndryshim të të drejtave për ndonjë kategori letrash me vlerë apo të të drejtave për aksionet, ku mund të konvertohen apo këmbehen letrat me vlerë të borxhit;

c) ndonjë ndryshim në drejtorinë e tij.

#### 12. Termat e shpërndarjes së letrave me vlerë

Emetuesi informon Komisionin dhe bursën për termat e shpërndarjes së letrave me vlerë të ofruara publikut, për nënshkrim ose shitje dhe për rezultatet e çdo të drejte të emtuar dhe, nëse është e zbatueshme edhe për kriteret e pranimit të aplikimeve shtesë, jo më vonë se mëngjesi i ditës së nesërme të punës pas postimit të “letrave të shpërndarjes” ose të dokumenteve të tjera të rëndësishme të pronësisë.

#### 13. Mbyllja e veprimtarisë dhe likuidimi

(1) Emetuesi informon menjëherë Komisionin dhe bursën, sapo ai të vihet në dijeni, për ndonjërin nga ngjarjet e mëposhtme:

a) paraqitjen në vendin e regjistrimit ose në ndonjë vend tjetër të themelimit, të ndonjë peticioni për pushimin e veprimtarisë apo të ndonjë aplikimi të të njëjtit lloj me të, apo dhënie e ndonjë urdhri për likuidim apo emërimin e ndonjë likuidatori të përkohshëm për emetuesin, shoqërinë kontrolluese të tij ose për ndonjë shoqëri kryesore, të kontrolluar prej tij;

b) miratimin e ndonjë rezolute nga emetuesi, shoqëria kontrolluese e tij ose nga ndonjë shoqëri kryesore, e kontrolluar prej tij, që tregon se likuidimi është bërë me dëshirën e anëtarëve a të kreditorëve;

c) zotërimin ose shitjen nga ndonjë pengmarrës të një pjese të mjeteve të emetuesit, që, në vlerë të përgjithshme përfaqëson një shumë mbi 15 për qind të mjeteve të konsoliduara fikse;

ç) dhënien e ndonjë gjykimi, deklarimi ose vendimi të marrë nga ndonjë gjykatë, qoftë kjo gjykatë e shkallës së parë apo e apelit, të cilat mund ta zhveshin emetuesin nga e drejta e zotërimit të një pjese të mjeteve të tij, të cilat, në vlerë të përgjithshme, përfaqësojnë një shumë mbi 15 për qind të mjeteve të konsoliduara fikse.

(2) Për qëllime të paragrafit (1), “një shoqëri kryesore e kontrolluar e emetuesit” nënkupton një shoqëri të kontrolluar prej emetuesit, që përfaqëson 15 për qind ose më shumë në mjetet e konsoliduara fikse ose në fitimin para tatimit.

#### 14. E drejta e Komisionit për të kërkuar informacion

(1) Komisioni, në çdo kohë, mund t'i kërkojë një emetuesi të marrë masa për t'i dorëzuar çdo informacion të kërkuar, brenda kufijve kohorë të përcaktuar dhe ta publikojë këtë informacion në formën dhe afatin e kërkuar nga Komisioni, për mbrojtjen e investitorëve dhe funksionimin e rregullt të tregut.

(2) Nëse një emetues nuk përmbush qoftë edhe një kërkesë për publikimin e informacionit, atëherë Komisioni mund ta publikojë vetë këtë informacion.

**KREU III**  
**MASA ADMINISTRATIVE**

15. Masat administrative naj emetuesve

(1) Nëse Komisioni vëren se një emetues ka shkelur ndonjerën nga pikat e kësaj rregulloreje, ai zbaton sipas rastit një ose disa nga sanksionet e mëposhtme:

a) Paralajmëron emetuesin për shkeljen e bërë.

b) Gjobit emetuesin.

c) Publikon faktin që emetuesi ka qenë i paralajmëruar ose i gjobitur për shkelje të kësaj rregulloreje.

ç) Pezullon ose nuk lejon tregtimin e mëtejshëm të letrave me vlerë të emetuesit.

(2) Në rastin e një emetuesi të gjobitur, sipas paragrafit (1/b), ky emetues duhet të paraqesë hollësi për gjobën në llogaritë e veta kontabël, të kontrolluara nga ekspertët kontabël në periudhën kur është vendosur gjoba.

16. Masa administrative ndaj një drejtori

Nëse Komisioni vëren se shkelja e kësaj rregulloreje nga një emetues ndodh për shkak të mosushtimit të plotë të përgjegjësive nga një ose disa drejtorë të tij, atëherë ai përveç sanksioneve ndaj emetuesit, sipas rregullit 16, mund të marrë, sipas rastit, një ose disa nga sanksionet e mëposhtme:

a) Paralajmëron drejtorët përgjegjës, kryesorë.

b) Gjobit drejtorët përgjegjës, kryesorë, me gjobë, por jo më shumë se 3 paga mujore.

c) Publikon faktin që këta drejtorë janë paralajmëruar ose gjobitur.

ç) Shpall publikisht, në rastin e dështimeve, të përsëritura dhe të qëllimshme, të një drejtori gjatë kryerjes së detyrës, se, sipas mendimit të tij, mbajtja e kësaj pozite nga drejtori është në kundërshtim me interesat e investitorëve.

d) Pezullon tregtimin ose ndërpret lejimin e tregtimit të letrave me vlerë të emetuesit, në rast se drejtori qëndron në detyrë edhe pas një lajmërimi të bërë sipas paragrafit ç.

17. Shpallja e masave administrative

Përveç rastit kur Komisioni vëren se për mbajtjen e një tregu të rregullt dhe për mbrojtjen e interesave të investitorëve duhet të veprojë ndryshe, ai, gjatë marrjes së masave të parashikuara, përkatësisht, në rregullin (15) dhe (16) për palët korresponduese:

a) bën një lajmërim paraprak për masën e propozuar prej tij;

b) fton bërjen me shkrim ose me gojë të ndonjë reklamimi nga palët e interesuara për vendimin e marrë;

c) njofton menjëherë vendimin e marrë;

ç) njofton me shkrim arsyet e marrjes së këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Illir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.49, datë 2.6.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu,     | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,       | Anëtar i ““                    |
| Gjergj Sauli,    | Anëtar i ““                    |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i ““                    |

|                 |          |    |
|-----------------|----------|----|
| Kristofor Peçi, | Anëtar i | ““ |
| Tefta Zaka,     | Anëtar i | ““ |
| Petrit Pllaçi,  | Anëtar i | ““ |
| Sokol Sadushi,  | Anëtar i | ““ |
| Kujtim Puto,    | Anëtar i | ““ |

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 31.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.52 Akti që i përket:

1. PARTIA SOCIALDEMOKRATE, përfaqësuar nga Kryetari, Skënder Gjinushi.
2. PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE, përfaqësuar nga zoti Arben Demeti, me aktpërfaqësimi.
3. PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, përfaqësuar nga Kryetari, Vasil Melo.
4. PARTIA DEMOKRATE, në mungesë.
5. PARTIA BASHKIMI DEMOKRAT, në mungesë.

#### SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, me akt-përfaqësimi.
2. KESHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKES SE SHQIPERISE, në mungesë.
3. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me aktpërfaqësimi.
4. PARTIA SOCIALISTE, përfaqësuar nga zotërinjtë Zamira Çaka dhe Spartak Braho.
5. PARTIA DEMOKRATIKE, në mungesë.
6. PARTIA REPUBLIKANE, përfaqësuar nga zoti Shkëlqim Barushi, me autorizim.
7. PARTIA DEMOKRISTIANE, në mungesë.
8. PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT, në mungesë.
9. PARTIA E BALLIT KOMBETAR, në mungesë.
10. PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT, përfaqësuar nga zoti Shaqir Hasani.
11. PARTIA AGRARE, në mungesë.

#### O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i shkronjave “ç e d” të nenit 66 dhe pikës 3 të nenit 87 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “kodi zgjedhor i republikës së shqipërisë”.

#### K Ë R K U E S :

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të neneve 66 dhe 87/3 të Kodit Zgjedhor:

Në shkronjën “ç” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor serviret një formulë korrektuese e gabuar dhe antikushtetuese, si dhe lejohet një marrëdhënie abuzive antikushtetuese, sepse shpërndarja e vendeve në Kuvend midis partive nuk bëhet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre.

- Përcaktimi i shkronjës “d” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor është i palogjikshëm e në kundërshtim flagrant me parimin kushtetues, sepse bën që votat e zgjedhësve për një parti të fitohen nga një parti tjetër.

- Pika 3 e nenit 87 të Kodit Zgjedhor është jo e plotë e me efekte antikushtetuese, sepse u lejon partive me elektorat të madh të regjistrojnë kandidatët e tyre si të pavarur për të fituar padrejtësisht më shumë mandate nga listat shumëëmërore.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuar, u njoh me përmbajtjen e dokumenteve në dosje dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

1. Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë përcaktohet në nenin 64 të Kushtetutës, në të cilin jepen tre komponentët kryesorë të tij. Së pari, numri 140 i deputetëve nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëëmërore, ndërsa 40 të tjerët zgjidhen nga listat shumëëmërore të partive ose koalicionëve të partive; së dyti, përcaktimi i numrit të deputetëve në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra nga çdo parti në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve dhe së treti, përjashtimi nga përfitimi prej listave shumëëmërore i partive e koalicionëve që marrin përkatësisht më pak se 2.5% dhe 4 % të votave.

Ndryshe nga sa pretendojnë kërkuesit, komponentët përbërës e karakterizojnë këtë sistem zgjedhesh si të përzier (miks), si me elementë të sistemit mazhoritar, ashtu edhe të atij proporcional. Elementë të mazhoritarit janë zgjedhja e mbi 2/3 të deputetëve në zonat njëëmërore dhe marrja për bazë e këtyre rezultateve në ndarjen e mandateve plotësuese, caktimi i numrit të saktë të deputetëve, pa lejuar rritjen e tij pavarësisht nga rezultati e nga mënyra e ndarjes së mandateve.

Elementët proporcionalë të sistemit dalin qartë nga kërkesa e nenit 64/2 të Kushtetutës për një raport sa më të afërt të numrit të deputetëve me votat e vlefshme të marra prej partive në të gjithë vendin.

Në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, në nenin 66 të Kodit Zgjedhor përcaktohet mënyra konkrete e ndarjes së 40 mandateve plotësuese. Në të jepen formulat që kombinojnë rezultatet në zonat njëëmërore me proporcionalitetin e ndarjes së mandateve sipas numrit të votave të marra. Në rastet kur në një ose më shumë zona kanë fituar kandidatë të pavarur ose kandidatë të partive e koalicionëve që marrin përkatësisht më pak se 2.5 e 4 %, si dhe në rastet kur partitë ose koalicionet fitojnë më shumë mandate se sa u takojnë në raport me votat e marra, zbatohet formula e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit të lartpërmendur. Kjo formulë përjashton nga përfitimi këto subjekte elektorale dhe i ndan mandatet për të gjithë subjektet e tjera, duke u nisur nga numri i mandateve që i takon çdo partie në raport me përqindjen e votave të vlefshme të fituara dhe nga numri i mandateve të fituara në votimin mazhoritar.

Sipas kërkuesve, pika “ç” e nenit 66 të Kodit Zgjedhor është antikushtetuese sepse gjenden formula më të mira që realizojnë një shpërndarje të mandateve në përputhje të plotë me nenin 64/2 të Kushtetutës. Veç kësaj, sipas tyre, nuk është e nevojshme që rregullimet e nenit 66 të parashikohen në Kodin Zgjedhor, sepse neni 64 i Kushtetutës është i plotë dhe në bazë të tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me akte nënligjore, nxjerr rregulla për të llogaritur drejtpërdrejt ndarjen e mandateve plotësues.

Në lidhje me formulën që jepet në shkronjën “ç” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, duhet patur parasysh se ajo bazohet në nenin 64/2 të Kushtetutës që përcakton numrin e përgjithshëm të deputetëve të çdo partie ose koalicioni partish në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve. Duke dhënë nocionin e raportit sa më të afërt dhe jo atë të raportit saktësisht të barabartë, Kushtetuta ka parasysh që sistemi i zgjedhjeve, i pranuar prej saj nuk është proporcional, por i kombinuar me zgjedhjet mazhoritare në 100 zonat nga të cilat jo vetëm del shumica e mandateve të Kuvendit, por mund të përcaktohen edhe drejtpërdrejt partitë fituese.

Parashtrimi nga kërkuesit i një formule që jep sipas tyre, një mënyrë të përafrit të raportit nuk do të thotë se formula ekzistuese është antikushtetuese. Vetë Kushtetuta nuk ka vendosur një kufizim të përcaktuar në mënyrë eksplicite të këtij raporti, por ka vendosur parimet e normat për ndarjen e mandateve në Kuvend, të cilat mund të konkretizohen nëpërmjet formulave përkatëse. Secila nga këto formula mund të jetë më e përshtatshme për rezultate të caktuara, por me sistemin e zgjedhjeve që ka pranuar Kushtetuta, që asnjëra prej tyre, nuk mund të kërkojë që të japë një raport

saktësisht të barabartë midis numrit të deputetëve të çdo partie dhe numrit të votave të vlefshme të fituara në shkallë vendi.

Pretendimi tjetër se në Kodin Zgjedhor nuk është e nevojshme të parashikohen formula për ndarjen e mandateve plotësuese e, si rrjedhojë gjithë neni 66 i Kodit Zgjedhor duhet të shfuqizohet, nuk është i bazuar. Sipas Kushtetutës dhe ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata Kushtetuese, duke qenë “ligjvënës negativ” vlerëson dhe shfuqizon ligjin ose pjesë të tij kur janë të papajtueshëm me Kushtetutën, por ajo nuk ka kompetencë të vlerësojë nëse ligji a pjesë të tij janë të nevojshëm. Kjo është kompetencë e vetë organit ligjvënës, i cili në rastin konkret ka vlerësuar nevojën e parashikimit në Kodin Zgjedhor të formulave e rregullave të tjera për ndarjen e mandateve plotësuese, sidomos në rastet kur disa subjekte elektorale përfitojnë jo vetëm mandate plotësuese që u takojnë atyre, por edhe kur ndajnë mandate plotësuese që i korrespondojnë votave të marra nga subjektet e tjera që përjashtohen nga ky përfitim.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se shkronja “ç” e nenit 66 të Kodit Zgjedhor nuk vjen ndesh me sistemin zgjedhor të sanksionuar në nenin 64 të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, kërkesa për shfuqizimin e saj duhet rrëzuar.

2. Neni 66 shkronja “d” i Kodit Zgjedhor ka këtë formulim: “Në qoftë se një kandidat i përbashkët i dy apo më shumë partive që nuk janë në koalicion zgjidhet deputet i një zone njëemërore, për efekt të llogaritjeve të shkronjës “c” konsiderohet se mandatin e tij e ka fituar ajo parti që ka fituar më shumë vota në shkallë vendi në raundin e parë, përveç kur partitë kanë rënë dakord ndryshe”.

Formulimi i dispozitës së mësipërme është antikushtetues, sepse vjen në kundërshtim me parimet e sanksionuara në nenin 1 pika 3 dhe 45, pika 4 të Kushtetutës për qeverisjen mbi bazën e zgjedhjeve të barabarta dhe për vlerësimin e barabartë të votës.

Nga përmbajtja e shkronjës “d” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor del se në të gjitha rastet, kur dy ose më shumë parti paraqiten në zgjedhje me kandidatë të përbashkët, dhe ky i fundit ka fituar në zonën zgjedhore, për efekte të ndarjes së mandateve plotësuese vota e shumë zgjedhësve do të vlerësohet në favor të partisë tjetër dhe jo në favor të partisë për të cilin ata kanë votuar. Ky qëndrim cenon kështu parimin e votës së barabartë që sanksionohet në nenin 45 pika 4 të Kushtetutës.

Caktimi i mandatit me marrëveshje midis partive vjen në kundërshtim edhe me parimin kushtetues të parashikuar në nenin 1 pika 3 të Kushtetutës për qeverisjen mbi bazën e një sistemi zgjedhjesh të barabarta, sepse krijon kushte që të marrin mandate e të dalin fituese parti me më pak zgjedhës. Nga ana tjetër, marrëveshja mund të çojë në deformimin e formulës, sepse lejon partitë me elektorat të madh që në zona zgjedhore të sigurt për to t’i regjistrojnë kandidatët e tyre si kandidatë të përbashkët me parti me pak elektorat, duke ua kaluar formalisht mandatin e deputetit këtyre partive, me qëllim që të fitojnë në proporcional më shumë mandate nga sa u takon.

Sa më lart, shfuqizimi i shkronjës “d” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, do të lejojë që mandati i deputetit të përbashkët t’i llogaritet secilës parti në proporcion me votat e marra nga ato në atë zonë zgjedhore.

3. Kërkuesit kanë kërkuar edhe shfuqizimin e pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor në pjesën që lejon të votohet për subjektet elektorale (partitë politike) në ato zona ku nuk kanë paraqitur kandidatë, duke pretenduar se ashtu siç është formuluar Kodi Zgjedhor u lejon partive me elektorat të madh që në zona zgjedhore të sigurt për to t’i regjistrojnë kandidatët e tyre si kandidatë të pavarur, me qëllim që të fitojnë më shumë mandate nga lista shumëemërore. Po sipas kërkuesve, fjalia e fundit e pikës 3 të këtij neni e formuluar: “Fleta e votimit për subjektet zgjedhore është e njëjtë për të gjitha zonat e zgjedhjeve” është pa kuptim e duhet interpretuar vetëm për partitë politike, por jo për gjithë subjektet zgjedhore, sepse sipas nenit 2 pika 25 të Kodit Zgjedhor në këta të fundit përfshihen edhe kandidatët e pavarur.

Gjykata Kushtetuese nuk gjen elementë antikushtetues në përcaktimet të pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor.

Sipas nenit 68 të Kushtetutës, rregullat për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve përcaktohen nga ligji për zgjedhjet. Ky i fundit (pra Kodi Zgjedhor) ka përcaktuar se zgjedhësi



voton me dy fletë të veçanta votimi, një për kandidatët që konkurrojnë drejtpërdrejt në zonë dhe tjetra për partitë politike që konkurrojnë në zgjedhje. Përcaktimi i mënyrës së votimit si më sipër ka vlerat e veta, sepse nëpërmjet votimit edhe për partitë që nuk kanë vënë kandidatë në një zonë i jepet mundësia zgjedhësve të shfaqin preferencat për alternativën që dëshirojnë në kushtet që ligji nuk mund t'i detyrojë partitë të paraqesin kudo kandidatë. Ajo nuk vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese të votës së lirë e të pluralizmit në parlament. Vetë votimi me dy fletë, një për kandidatët e tjetra për subjektet elektorale dhe e drejta e çdo zgjedhësi për të dhënë votën për alternativën e çdo partie edhe kur kjo nuk ka paraqitur kandidatë ose kur ai nuk e miraton kandidatin e saj, shpreh synimin e nenit 64 të Kushtetutës për t'i dhënë mundësitë gjithë partive të konkurrojnë në gjithë vendin e të marrin votat e elektoratit të tyre.

Përsa i përket pretendimit se partitë mund të spekullojnë me kandidatët e pavarur, Kodi Zgjedhor ka ngarkuar komisionet e zgjedhjeve të drejtojnë e kontrollojnë zbatimin e ligjit në procesin zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr në zbatim të ligjit vendime për pavlefshmërinë ose jo të zgjedhjeve në zona, si dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në gjithë territorin e Republikës për të marrë masat për parandalimin e shkeljeve e për të mbajtur qëndrimin e duhur ndaj tyre.

Pretendimi tjetër i kërkuesit se fjalitë e fundit e pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor duhet të shfuqizohet si antikushtetuese edhe për arsye se ngatërron konceptin subjekt zgjedhor me përkufizimin që jep neni 2 pika 25 e Kodit Zgjedhor për këto subjekte, nuk përbën shkak për antikushtetueshmëri. Pavarësisht nga ndonjë keqkuptim që mund të krijohet nga mënyra e të interpretuarit dhe të zbatuarit në praktikë të termit subjekt zgjedhor, Gjykata Kushtetuese çmon se ai nuk duhet vlerësuar i shkëputur nga kuptimi që mbart në vetvete neni 87 i Kodit Zgjedhor, në raport me nenin 45 pika 4 të Kushtetutës, për të drejtën e shtetasve për të votuar lirisht për atë që dëshirojnë si, dhe me të drejtën e partive politike apo të koalicioneve për të konkurruar pa asnjë kufizim me alternativën e tyre në të gjitha zonat e zgjedhjeve.

Përsa sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se kërkesa duhet pranuar për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shkronjës “d” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor dhe duhet rrëzuar për shfuqizimin e shkronjës “ç” të nenit 66 e të pikës 3 të nenit 87 të këtij Kodi.

Përsa i përket hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar nenit 132 pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 26 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe duke vlerësuar nevojën për zgjidhjen e shpejtë të problemeve të dala në praktikë, arriti në përfundimin se ky vendim duhet të hyjë në fuqi menjëherë.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shkronjës “d” të nenit 66 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e shkronjës “ç” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor.
- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

## MENDIMI I PAKICËS

Jam për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 66, si dhe të fjalisë së fundit të pikës 3 të nenit 87 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Kam arritur në këto përfundime kategorike, duke arsyetuar sa më poshtë:

### 1. Për nenin 66 të Kodit Zgjedhor

Neni 64 i Kushtetutës, në mënyrë të plotë dhe pa ekuivoqe ka përcaktuar sistemin elektoral në Shqipëri (atë të përzier), duke shtjelluar në imtësi pjesën më të rëndësishme e më të komplikuar të këtij sistemi, atë të mënyrës së ndarjes së mandateve nga lista shumëemërore.

Përse Kushtetuta jonë, në dallim nga mjaft kushtetuta të tjera në botë mori përsipër rregullimin tërësor të sistemit të zgjedhjeve, e shpjegon qartë Raporti i Komisionit të Hartimit të Kushtetutës, ku ndër aktorët kryesorë të tij kanë qenë pikërisht të njëjtët persona përfaqësues të subjekteve të interesuar, të cilët në procesin aktual gjyqësor u përpoqën, por pa argumenta, të mbronin tezën e kundërt.

Në këtë raport të Komisionit thuhet shprehimisht:

“Është fiksuar në tekst formula e zgjedhjeve të Kuvendit, gjë që është bërë deri tani nëpërmjet ligjeve elektorale. Komisioni, pas debatesh të gjata, ka menduar se një hap i tillë është i domosdoshëm për të kapërcyer klimën e mosbesimit politik që zotëron në vend, për të mënjanuar manipulimet në ligjin elektoral në prag të zgjedhjeve, dukuri që është vënë re disa herë dhe që ka pasur pasoja të ndjeshme si në gjeografinë politike të vendit, ashtu dhe në qeverisjen e tij vitet e fundit” (fq.22). Veç kësaj teze, e cila shërben për të kuptuar në rastin në fjalë atë që quhet “ratio legis”, ka dhe argumente të tjerë, në mbështetje të mendimit tim. Kështu, Kushtetuta, në nenin 68 pika 2, autorizon nxjerrjen e ligjit për zgjedhjet duke përcaktuar në mënyrë taksative se çfarë duhet të rregullojë ky ligj konkretisht. Nga këto rregulla, del që të jetë përjashtuar rregullimi i sistemit elektoral, me fjalë të tjera, që Kushtetuta të mos ketë autorizuar ligjin për zgjedhjet që të merret me rregullimin e problemeve të sistemit elektoral. Dhe kjo për arsyen e thjeshtë e të kuptueshme për çdo njeri që do të kuptojë se vetë Kushtetuta e ka rregulluar në mënyrë të plotë këtë aspekt, sa të rëndësishëm, aq dhe burim konfliktesh në realitetin shqiptar.

Antikushtetueshmëria e nenit 66 të Kodit Zgjedhor nuk qëndron thjesht vetëm në anën juridiko-formale që shtjellova më lart, por edhe në themel.

Kërkuesit, në kërkesën e tyre, kanë demonstruar disa përlllogaritje, sipas të cilave ata argumentojnë se zbatimi drejtpërdrejt i nenit 64 të Kushtetutës garanton “raporte sa më të afërta” midis votave të vlefshme të marra për çdo parti apo koalicion me numrin e përgjithshëm të deputetëve të çdo partie - kushti më esencial në zbatimin e formulës të pranuar nga Kushtetuta. Njëkohësisht, po me përlllogaritje ata treguan se formula e pranuar në nenin 66 të Kodit Zgjedhor, jo vetëm në përmbajtje nuk përputhet me Kushtetutën, por (dhe kjo është përcaktuese) nuk garanton “raporte sa më të afërta”. Këto përlllogaritje nuk u goditën për saktësi nga asnjë prej përfaqësuesve të subjekteve të interesuara, si dhe as u kërkua e as u pa e nevojshme nënshtrimi i këtyre përlllogaritjeve një ekspertimi. Për pasojë, për mua si gjyqtar ato duhen pranuar si të sakta.

Në këto kushte, kur neni 66 është një dispozitë që arbitrarisht zëvendëson dispozitën kushtetuese, kur ajo ka dalë jashtë autorizimit kushtetues e për më tepër kur shtrembëron sistemin elektoral të përcaktuar rigorozisht në Kushtetutë, pakicës nuk i mbetet gjë tjetër veç ta konsiderojë atë antikushtetuese e me pasoja për praktikën elektorale. Shfuqizimi i shkronjës “d” të kësaj dispozite nga shumica nuk zgjidhi asnjë problem që ka të bëjë me kushtetutshmërinë e vetë dispozitës.

### 2. Për fjalinë e fundit të nenit 87 të Kodit

Edhe pse kam kundërshtim në tërësi për pikën 3 të nenit 87 të Kodit, duke qëndruar brenda kufijve të kërkesës, kam mendimin se fjalia e fundit e pikës 3 është antikushtetuese e duhej të anulohet. Që kjo dispozitë është antikushtetuese, më mirë se vetë kërkuesit këtë e argumentoi (padashur) me shpjegimet që dha në seancë gjyqësore përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sipas tij, fleta e votimit për listat shumëemërore është e njëjtë në të gjithë vendin, si në formë, edhe në përmbajtje. Me fjalë të tjera, edhe pse parti politike në zona të ndryshme mund të mos përfaqësohen nga kandidatë (të listës njëemërore), ato do të përfaqësohen në listën

shumëemërore në të gjithë vendin. Pavarësisht se një përmbajtje dhe interpretim i tillë i dispozitës së lartpërmendur po i jep frutet e veta thellësisht negative me të ashtëquajturit “kandidatë të pavarur” për Gjykatën Kushtetuese, interes duhej të kishte fakti se në këtë mënyrë çenohet rëndë sistemi elektoral i pranuar nga neni 64 i Kushtetutës.

Nëse në zona të caktuara, parti të caktuara do të përfaqësohen nominalisht vetëm në listën shumëemërore, pa pasur kandidatë në listën njëemërore ose duke paraqitur kandidatë “të pavarur” për ato parti e në ato zona, sistemi elektoral merr trajtat e plota të sistemit proporcional, duke shtrembëruar sistemin e pranuar nga dispozita e mësipërme kushtetuese (atë të përzierë) dhe duke krijuar e thelluar pabarazitë midis subjekteve elektorale në zgjedhje.

Duke përfunduar doja të theksoja se antikushtetutshmërinë e dispozitave të mësipërme Gjykata duhej ta shihte jo vetëm përse theksuam më lart, por mbi të gjitha nën prizmin e respektimit të parimeve themelore kushtetuese që duhet të jenë baza e shtetit, midis të cilëve pluralizmi politik zë një vend të posaçëm (neni 3).

Mosshfuqizimi i dy dispozitave të kontestuara, së fundi, do të thosha se krijon shteg për atë që ekzaktësisht ka dashur të mënjanojë Kushtetuta “pasojat e ndjeshme, si në gjeografinë politike të vendit, ashtu dhe në qeverisjen e tij” (Raporti).

A N Ë T A R  
A. Karamuço

## MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me shumicën për këto arsye:

Sipas nenit 3 të Kushtetutës, një ndër elementët që konsiderohen si baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë ata, është edhe pluralizmi. Në vazhdim të kësaj dispozite, për mbrojtjen e sistemit pluralist, Kushtetuta në nenin 64 përcakton se 100 deputetë zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore ndërsa 40 të tjerët zgjidhen nga listat shumëemërore të partive ose koalicioneve sipas renditjes në to. Në pikën 2 të këtij neni thuhet se numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie ose koalicioni përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

Por, neni 66 i Kodit Zgjedhor për ndarjen e mandateve plotësuese vendos rregulla të tjera, zbatimi i të cilave të çon në shmangie nga kriteri kushtetues i raportit sa më të afërt dhe në cenim të pluralizmit. Këto shmangie janë më të mëdha në shkronjat “ç” dhe “d” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor. Është e vërtetë se Kushtetuta, duke përdorur këtë shprehje, nuk ka parasysh barazinë absolute, gjë që praktikisht është e pamundur, por gjithsesi kërkon raport sa më të afërt dhe jo thjesht raport të afërt. Duke u nisur nga kriteri kushtetues që mbron sistemin pluralist, shmangia që lejon ligji bie në kundërshtim me parimin e zgjedhjeve të lira e të barabarta.

Sipas nenit 64/2 të Kushtetutës, numri i deputetëve të çdo partie dhe koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre, ndërsa në shkronjën “ç” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, duke bërë përjashtim nga rregulli dhe shmangia nga ky përcaktim kushtetues, bëhet vlerësimi edhe për votat që fitojnë kandidatët e pavarur ose kandidatët e partive që nuk kalojnë pragun përkatës.

Sistemi proporcional, i cili bazohet në ndarjen e vendeve në parlament për subjektet zgjedhore sipas përqindjes së votave të fituara, është i preferuar nga qeverisjet demokratike, sepse u krijon mundësi edhe partive të vogla të përfaqësohen në parlament. Por, për të shmangur përfaqësimin e një numri të madh të partive të vogla që mund të rrezikojë procesin legjislativ me moskrijimin e shumicës, vendoset një përqindje minimale e fitimit të votave në raundin e parë të zgjedhjeve që t’u japë mundësi subjekteve zgjedhore të hyjnë në parlament. Sipas Kushtetutës tonë, ky kufi është 2.5 % për partitë dhe 4 % për koalicionet e partive. Shtete të tjera kanë përqindje të ndryshme, por gjithmonë minimale dhe të përafërta (në Gjermani 5 %, në Austri 4 %, etj.).

Këto kriteret kushtetuese (në shtete të tjera edhe ligjore), nuk mund të shkelen, sepse

deformohet sistemi i zgjedhjeve dhe prishen ekuilibrat, po të përfaqësohen më shumë se sa duhet parti të vogla në parlament. Ky është i vetmi kufizim kushtetues për partitë e vogla, ndërsa kufizimet e tjera sipas germës “ç” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor janë antikushtetuese.

Përsa i përket pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor, fjalía e fundit, siç pretendohet edhe nga kërkuesit, është e pakuptueshme dhe e pazbatueshme, për rrjedhojë dhe antikushtetuese, sepse lë shteg për interpretime të ndryshme e kontradiktore dhe deformon sistemin e zgjedhjeve. Po të mbahet parasysh kuptimi që vetë ligji (Kodi Zgjedhor) i jep subjekteve zgjedhore në nenin 2 pika 25, del më qartë antikushtetutshmëria e pikës 3 të nenit 87 dhe pikërisht të fjalisë së fundit të saj. Në nenin 2/25 thuhet se subjekte zgjedhore janë partitë politike dhe koalicionet e regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe kandidatët e tyre dhe kandidatët e pavarur të regjistruar në Komisionin e Zonës Zgjedhore ose Komisionin e Zgjedhjeve të Qeverisjes Vendore.

Me formulime të tilla të dispozitave ligjore lihet shteg që në praktikë partitë me elektorat më të madh të spekullojnë me kandidatët e tyre, duke i paraqitur si “kandidatë të pavarur”, me qëllim që të fitojnë një numër sa më të madh mandatesh nga lista shumëemërore. Prandaj, shfuqizimi i kësaj pjese të pikës 3 të nenit 87 është i domosdoshëm për të ndaluar praktika të tilla antikushtetuese dhe për të zbatuar drejt ligjin, sipas të cilit kandidat i pavarur është ai kandidat që nuk mbështetet nga asnjë parti politike.

Shfuqizimi i këtyre pjesëve në nenet 66 e 87 të Kodit Zgjedhor, që kanë të bëjnë me llogaritjen e gabuar të mandateve plotësuese dhe me spekulimin me kandidatët e pavarur, nuk krijon ndonjë boshllëk ligjor. Vetë Kushtetuta, por edhe Kodi Zgjedhor në dispozita të veçanta (siç është edhe nenit 66 shronjat “a, b, c, etj.”), kanë përcaktuar kriteret dhe mënyrën e ndarjes së mandateve plotësuese.

A N Ë T A R  
K. Peçi

## MENDIMI I PAKICËS

Pajtohem plotësisht me mendimet e shfaqura nga nga zoti Karamuço, rreth qëndrimit që duhej të mbante Gjykata Kushtetuese ndaj kërkesës së partive të vogla, me objekt shfuqizimin si antikushtetues të nenit 66 shkronjat “ç e d” dhe nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor.

Për mendimin tim, neni 66 i këtij Kodi duhej të shfuqizohej i tëri. Formulimi i tij i shmanget kërkesave të nenit 64 të Kushtetutës. Mënyra e parashikuar në të për përcaktimin e mandateve shtesë, të çon në rezultate të tjera, të cilat nuk përputhen me ato që do të dilnin po të zbatohesh me korrektësi urdhërimi kushtetues që “numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie ose koalicioni partish përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve”.

Kjo mospërputhje midis ligjit në këtë pjesë dhe Kushtetutës është e evidente. Gjykata Kushtetuese duhej ta sheshonte këtë kontradiktë, duke shfuqizuar të gjithë nenin 66 të Kodit Zgjedhor. Me shfuqizimin e tij nuk krijohet boshllëk ligjor për vetë faktin se ekziston mundësia e zbatimit të drejtpërdrejtë të pikës 2 të nenit 64 të Kushtetutës.

Jam për pranimin e kërkesës edhe përsa i përket shfuqizimit të pikës 3 të nenit 87 të Kodit Zgjedhor. Përmbajtja e kësaj dispozite vjen përsëri në kundërshtim me sistemin e zgjedhjeve, të sanksionuar në nenin 64 të Kushtetutës.

Kushtetuta, duke parashikuar që vendet në parlament të ndahen jo vetëm sipas sistemit mazhoritar, por dhe atij proporcional, ka pasur për qëllim që në këtë organ të marrin pjesë sa më shumë forca politike, sepse pluralizmi, sipas nenit 3 të Kushtetutës, përbën një nga bazat e këtij shteti.

Partitë e vogla, ndonëse aktualisht ndodhen në minorancë, në kushtet e një shteti demokratik, kanë mundësi që nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike të kthehen në parti të mazhorancës.

Mirëpo pika 3 e nenit 87 të Kodit Zgjedhor, ashtu siç është formuluar, ka krijuar hapësira që partitë e mëdha të spekullojnë nëpërmjet kandidatëve të pavarur për të eliminuar ose kufizuar të drejtën e partive të vogla që të përfitojnë në ndarjen e mandateve shtesë nëpërmjet sistemit proporcional.

Ky fenomen ka filluar të shfaqet realisht që tani në fazën parazgjedhore. Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, si parti me një elektorat më të madh, në ato zona ku kanë siguri se elektorati anon nga ana e tyre, nuk kanë caktuar kandidatë në listat njëemërore, por kanë shtyrë anëtarët ose simpatizantët e tyre që të regjistrohen si kandidatë të pavarur, duke i mbështetur këta me financime dhe me të gjitha mjetet e tjera të propagandës.

Qëllimi i tyre, siç e kanë deklaruar edhe haptaz, është që të përfitojnë sa më shumë mandate shtesë në kurriz të partive të vogla, pa marrë parasysh se në këtë mënyrë i kundërvihen parimit kushtetues që synon të sigurojë karakterin pluralist të Kuvendit.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese në mbështetje të nenit 64 të Kushtetutës, duhej të shfuqizonte këtë dispozitë të nenit 87 të Kodit Zgjedhor dhe, për të mënjeluar këtë fenomen antikushtetues, të orientonte nëpërmjet vendimit të saj, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që ky të nxirrte udhëzime ku të parashikohej që çdo parti politike, për të konkurruar në ndarjen proporcionale si subjekt elektorale, detyrimisht duhet të caktojë më parë kandidatin e saj me siglën e vet në zonën njëemërore. Kjo për arsye se zbatimi i këtij sistemi që është në funksion të detyrimit kushtetues për një Kuvend sa më pluralist, kërkon në mënyrë të domosdoshme që të ekzistojë lidhja midis listës së kandidatëve në zonat njëemërore dhe listës së partive politike që duan të kandidojnë si subjekte për të përfituar në ndarjen e 40 mandateve plotësuese.

**A N Ë T A R**  
**Z. Vuci**

**V E N D I M**  
**Nr.53, datë 27.6.2001**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |                                |
|------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu      | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci,       | Anëtar i ““                    |
| Gjergj Sauli,    | Anëtar i ““                    |
| Alfred Karamuço, | Anëtar i ““                    |
| Kristofor Peçi,  | Anëtar i ““                    |
| Kujtim Puto,     | Anëtar i ““                    |
| Tefta Zaka,      | Anëtar i ““                    |
| Petrit Pllaçi,   | Anëtar i ““                    |
| Sokol Sadushi,   | Anëtar i ““                    |

me sekretare Arbenka Lalica, më dtë 30.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35 Akti që i përket:

**K Ë R K U E S:** GENTIAN HAMZAI, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi,  
me autorizim.

**O B J E K T I**

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.76, datë 2.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.361, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Avokati i të gjykuarit në mungesë, pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe vendimi i Kolegjit Penal të gjykatës së Lartë, të cilët kanë vendosur moslegjitimitimin të të gjykuarit

në mungesë për të bërë ankim, pasi nuk ka qenë i pajisur me prokurë nga vetë i gjykuari, janë antikushtetues dhe kërkon shfuqizimin e tyre, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Në rastin konkret, ndodhemi përpara një procesi të parrregullt ligjor, pasi të pandehurit i është mohuar një nga të drejtat themelore kushtetuese, e drejta e mbrojtjes.

- Vendimet e sipërcituara bien ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar si antikushtetues qëndrimin e mbajtur nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për këtë problem.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, avokatin e të gjykuarit në mungesë dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

Mbi ankimin e mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë të caktuar kryesisht, Gjykata e Apelit të Tiranës me vendimin nr.76, datë 2.3.2000, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se ai nuk legjitimohet të bëjë ankim, derisa nuk është pajisur me prokurë nga vetë i gjykuari.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke ju referuar vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë datë 29.7.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës me të njëjtin arsyetim.

Pretendimi i kërkuesit, se gjykatat kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sepse padrejtësisht i kanë mohuar mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimeve gjyqësore, është i drejtë dhe kërkesa duhet pranuar.

E drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor është një e drejtë kushtetuese dhe askush nuk mund të privohet nga realizimi i saj. E drejta e ankimit të të gjykuarit, si një garanci që i shërben realizimit të të drejtës së mbrojtjes nuk mund t'i mohohet avokatit të tij, pasi edhe në rastin e gjykimit në mungesë mbrojtësi gëzon të gjitha të drejtat, për sa kohë që vetë i gjykuari nuk ia ka hequr atij në mënyrë të shprehur të drejtën e përfaqësimit.

Çështja e realizimit të të drejtës së ankimit nga mbrojtësi i të gjykuarit në mungesë, i caktuar nga familjarët e tij ose kryesisht nga gjykata, përbën tashmë dhe një qëndrim që po zbatohet në praktikën e gjykatave të zakonshme, si rrjedhojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 17.4.2000 dhe nr.5, datë 7.2.2001. Në këto vendime të Gjykatës Kushtetuese është konfirmuar përfundimisht, në aspektin kushtetues dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, se e drejta e ankimit i përket edhe mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë, pavarësisht nga forma e përfaqësimit, si një nga kushtet për realizimin e së drejtës së mbrojtjes.

Mbi bazën e argumenteve të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin, se vendimet e gjykatës së apelit dhe të kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mohuar të drejtën e mbrojtësit të të gjykuarit në mungesë për të bërë ankim ndaj vendimeve gjyqësore, kanë cenuar njëkohësisht edhe të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, shkelje këto që bien ndesh me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

### V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.76, datë 2.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.361, datë 5.10.2000 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes së Gjykatës së Apelit Tiranë.  
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**V E N D I M**  
**(I SHKURTUAR)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit me vendimin nr.700, datë 15.6.2001 shpallë të zhdukur shtetasin Sokol Nebi Bida që nga data 4.9.1997.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 29.6.2001  
Doli nga shtypi më 5.7.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë